




Program i përbashkët me Gjermaninë për bujqësinë! Krifca: Nis në janar, ndihma për fermerët

Faqe 4



Modelet e zhvillimit socio-ekonomik për zonat rurale

Faqe 4



Axhenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, MBZHR: Shqipëria reforma konkrete

Faqe 7



AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit nëntor 2022

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 450
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

SHQIPËRIA MERR PRESIDENCËN E BORDIT DREJTUES TË CIHEAM

MINISTRJA E BUJQËSISË SË SHQIPËRISË, FRIDA KRIFCA ZGJIDHET PRESIDENTE E BORDIT DREJTUES TË QENDRËS NDËRKOMBËTARE PËR STUDIME TË AVANCUARA AGRONOMIKE MESDHETARE

Delegacionet e 13 shteteve anëtare të organizatës, në mbledhjen e 151-të që u mbajt në Institutin Oqeanografik të Parisit (Francë) përzgjedhën kandidaten nga Shqipëria, Frida Krifca që do të jetë gruaja e parë në krye të Bordit Drejtues të CIHEAM pas 60 vitesh. Ministria Krifca me veprimtarinë e saj në fushën e bujqësisë ka marrë besimin për të vazhduar edhe më tej përpjekjet e organizatës në zhvillimin e sektorit

Përgatitën: Pandeli Pasko (CIHEAM Bari), Francesco Ceglie (Koordinator i Projektit SAFIAL – CIHEAM Bari)

RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Orientimi drejt tregut të punës, RisiAlbania mbështet UBT-në



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2

STANDARDE

Cilat janë problematikat me PMB-të dhe me listat e tyre në zbatimin e GlobalGAP?

Andon Rrapokushi
Menaxher i Sigurisë Ushqimore Doni Fruits

Faqe 2



PROFIL

Ëndrra amerikane u bë realitet

- Kushtuar familjes së agronomit Selman Skëndajt, që prej 23 vjetësh jeton në Amerikë -

Nga: Fuat Memelli, Boston

Faqe 10

KËNDI I EKSPERTIT

- Këshilla për fermerë të cilët merren me kultivimin e bimës së grurit Fq.11
- Këshilla për fermerët që mbarështojnë bagëti të imta Fq.11
- Këshilla për kultivuesit e mollës Fq.12
- Kalendari bujqësor, muaji dhjetor 2022 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

Zëvendësministri Civici: Synojmë politika që lehtësojnë sipërmarrjet rurale, eksportet bujqësore janë rritur në vlerë dhe sasi

Çel edicionin e tretë të panairit Ndërkombëtar të Bujqësisë, Blegtorisë dhe Kopshtarisë 2022



Faqe 2

SONDAZHI

AZHBR: 92% e fermerëve informacion të plotë për aplikimin në IPARD II



Faqe 5

RISI ALBANIA

Orientimi drejt tregut të punës,
RisiAlbania mbështet UBT-në

Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) intensifikon bashkëpunimin me partnerë ndërkombëtar në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve mësimore dhe zba-

Momendumi u firmos nga Rektori i UBT, Z. Fatbardh Sallaku dhe nga përfaqësuesit e RisiAlbania Z. Stefan Joss, Drejtor i projektit dhe Znj. Edlira Muedini, menaxhere.

ka mbështetur zhvillimin e shërbimit të karrierës në këtë Universitet.

Projekti RisiAlbania do të mbështesë Universitetin për të forcuar shërbimin e këshillimit të karrierës për studentët dhe të diplomuarit e tyre, nëpërmjet:

- Procesit të ngritjes së kapaciteteve të këshilltarëve të karrierës për ofrimin e shërbimeve nëpërmjet trajnimeve në grup, dhe mbështetjes së vazhdueshme për përfshirjen e personelit të lidhur me këshillimin e karrierës në aktivitete shkëmbimi, ngjarje tematike të fokusuara dhe aktivitete të tjera mbështetëse ad hoc.

- Zhvillimit të sistemit të brendshëm të menaxhimit të karrierës, për të promovuar automatizimin dhe dixhitalizimin e shërbimeve,

- Diversifikimit të shërbimeve të karrierës, duke zhvilluar më tej përmbajtjen, mjetet (dixhitale dhe jo dixhitale),

- Aktiviteteve promovuese të shërbimeve të karrierës për të rritur ndërgjegjësimin e studentëve me qëllim rritjen e kërkesës për këto shërbime.

Të dyja palët mbeten të angazhuara për të konsoliduar dhe për të diversifikuar më tej shërbimin e karrierës të ofruar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës



timit të praktikave më të mira europiane që i shërbejnë arsim-it profesionin dhe orientimit dhe këshillimit në karrierë punësimi, në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.


Në këtë kuadër Universiteti Bujqësor i Tiranës nënshkroi një Memorandum Bashkëpunimi me RisiAlbania, një komponent i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) që operon fort në vendin tonë në drejtim të këshillimit të karrierës.

Të pranishëm ishin dhe Znj. Ermira Shyti, në cilësinë e zbatueses së projektit dhe Prof. Asoc. Dritan Laçi si Përgjegjës i Qendrës së Karrierës dhe Alumni në UBT.

Synimi i këtij takimi është inkurajimi i bashkëpunimit bazuar në marrëveshjet ndërshtetërore të nënshkruara ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Zvicrës. RisiAlbania ka bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës që nga viti 2008 dhe

Cilat janë problematikat me PMB-të dhe me listat e tyre në zbatimin e GlobalGAP?

Andon Rrapokushi
Menaxher i Sigurisë Ushqimore Doni Fruits



Pyetja është shumë specifike dhe i referohet vetëm një standardi, GlobalG.A.P. Në fakt problematikat e lidhura me listat e pesticideve janë prezente dhe përfshijnë të gjithë prodhuesit, të certifikuar dhe jo të certifikuar dhe përveç tyre, farmacistë bujqësorë, të cilat luajnë një rol primar së bashku me specialistët e mbrojtjes së bimëve.

Nëse do t'i referoheshim zbatimit të certifikimit GLOBALG.A.P., rregullat janë shumë më të forta dhe strikte. Kompanitë importuese europiane, sidomos ato të zonës së BE-së, që ble-

jnë produkte nga pikat tona të grumbullimit, kanë kërkesa të forta për cilësinë dhe pastërtinë e produkteve dhe kërkojnë të zbatohet Rregullorja e Komisionit Europian nr. 1881/2006 e 19 dhjetorit 2006 e cila përcakton nivelet më të larta të ndotjeve (MRL) të përcaktuara në produktet ushqimore, si edhe rregullat dhe vendimet e reja që dalin në lidhje me kufirin maksimal të lejueshëm të ndotjeve.

Kur flasim për listat e PMB-ve, në Republikën e Shqipërisë dihet që janë publike dy lloje listash, lista nr. 1 (e PMB-ve që lejohen të importohen, të tregtohen dhe të përdoren në RSH) dhe lista nr. 2 (e PMB-ve që nuk lejohen të importohen por vetëm të tregtohen dhe përdoren në RSH).

Që këtu lindin problematikat, sepse **PMB-të e listës së dytë janë të ndaluara të përdoren në Bashkimin Europian, por lejohen në vendon tonë.** Pra, për ta thënë më thjeshtë, tregtari i farmacistë bujqësorë që e shet një produkt me substancë aktive të ndaluar

sipas listës nr. 2 dhe fermeri që e përdor atë për trajtimin e bimës, janë në rregull me ligjin e shtetit shqiptar. Nga ana tjetër, produkti që kultivon fermeri, qoftë perime apo frut, nuk mund të eksportohet në asnjë vend të BE-së, nëqoftëse ai është trajtuar me një substancë të ndaluar dhe mbetet që ky produkt të shitet dhe të konsumohet në Shqipëri.

Problemi tjetër që del është i lidhur me kohëzgjatjen e shitjes dhe të përdorimit të pesticideve të ndaluara por të lejuara për t'u përdorur; për sa kohë do të përdoret pestidici i ndaluar dhe si do të kontrollohet heqja e tij nga tregu i inputeve bujqësore? Përderisa ai është konsideruar i rrezikshëm nga Komisioni Europian dhe posaçërisht nga EFSA (European Food Safety Authority) atëhere edhe në vendin tonë duhet vendosur një afat maksimal kohor, përtej të cilit ai produkt absolutisht nuk duhet të figurojë më në tregun tonë dhe nuk duhet as të shitet dhe

(Vijon në faqen 7)

BASHKËPUNIM

Turqia mbështetje Bujqësisë, Krifca: Investime në argjinatura dhe kanale kulluese

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Frida Krifca, e pranishme sot në Durrës në ceremoninë e dorëzimit të mjeteve të rënda, dhuratë nga qeveria e Turqisë, e vuri theksin se kjo ndihmë e shtetit turk vjen në një moment të rëndësishëm, kur në qarqet e Lezhës dhe Shkodrës përballlemi me situatën e reshjeve intensive.

Në një deklaratë të përbashkët me ambasadorin e Turqisë në Tiranë, Tayyar Kagan Atay, ministrja Krifca u shpreh se, "më vjen mirë të them që situata është nën kontroll dhe sot sipërfaqet e tokave në ujë po kullohen nëpërmjet hidrovoreve që janë në funksion të plotë".

Ministrja shprehu mirënjohjen për këtë mbështetje të qeverisë turke, teksa tha se investimet në ujë, kullim e argjinatura janë prioriteti i MBZHR-së.

"Nga viti 2013 ne kemi bërë investime të rëndësishme në vlerën e 23 miliardë lekëve duke rritur sipërfaqen e ujitshme në 270 mijë ha. Kemi ndërtuar 90 km argjinatura, ku 13 km argjinatura janë vetëm në qarkun e Shkodrës. Kemi gjithashtu investime edhe në pasurimin e flotës me ndikim të

drejtëpërdrejtë në mbështetjen e bujqësisë", përfundoi Krifca.

Nga ana e tij ambasadori turk shprehu gatishmërinë për forcimin e bashkëpunimit mes

shqiptar në çdo situatë", deklaroi ambasadori Atay.

Investimet në sistemin e ujitjes dhe kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet, të



dy vendeve, teksa tha se "jam sot këtu për të theksuar faktin se edhe ne si Turqi do të vijojmë të qëndrojmë pranë Shqipërisë si mike, aleate dhe partnere strategjike".

Me këtë rast, vuri në dukje ai, në këtë ceremoni simbolike në dorëzimin e këtyre mjeteve që i vijnë në ndihmë ministrisë në këtë periudhë me reshje të dendura, shpresojmë të minimizojmë sado pak problemet.

"Jemi të gatshëm t'ju mbështesim në këtë bashkëpunim të shkëlqyer mes dy vendeve. Populli turk do të vijojë të qëndrojë gjithmonë pranë popullit

cilat rezultuan vendimtare në situatën më të fundit me reshjet intensive që përfshinë vendin, nuk janë ndalur për asnjë moment nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Sektori mbart rëndësi të veçantë për fermerët të cilëve u vjen në ndihmë për ujitjen dhe kullimin e tokave në sezonet e prodhimit, por veçanërisht në momentet e situatës së reshjeve të dendura, duke mundësuar kullimin e shpejtë të ujit dhe mbajtjen e tokës në gjendje kultivimi.

Zëvendësministri Civici: Synojmë politika që lehtësojnë sipërmarrjet rurale, eksportet bujqësore janë rritur në vlerë dhe sasi

Çel edicionin e tretë të panairit Ndërkombëtar të Bujqësisë, Blegtorisë dhe Kopshtarisë 2022

Nga data 24 - 26 dhjetor u zhvilluam edicioni i tretë i Panairit Ndërkombëtar të Bujqësisë, Blegtorisë dhe Kopshtarisë 2022 nga Exposita Albania.

Ky panair bëri bashkë aktorët më të rëndësishëm të sektorëve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Qëllimi kryesorë i këtij eventit është krijimi i mundësive për bashkëpunime biznesi

dave në këtë panair dëshmon qartë rëndësinë për bashkëpunim në Agrobiznes.

"Numri i madh i standave në këtë panair tregon që bujqësia është bërë një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë. Për këtë arsye, ky edicion synon të organizohet çdo vit në mënyrë që të jemi sa më pranë aktorëve kryesorë të këtij sek-

punën e të gjithëve duke bërë ajo të vlerësohet edhe më shumë.

Zëvendësministri i Bujqësisë, z. Enio Civici u shpreh që bujqësia po vazhdon të ketë ritme të larta. "Dua t'ju them që në këtë edicion të tretë për këtë sektor, bujqësia vazhdon të ecë me ritme të larta. duke matur nivelet e eksporteve edhe në vlerë. Në këtë panair kompanitë tregojnë produktin e tyre të shumë viteve punë dhe ne si ministri po mundohemi të krijojmë lehtësira për të gjitha këto kompani. Uroj që përveç marrëveshjeve të bashkëpunimit të mblidhemi edhe për të rritur më shumë aktivitetin ekonomik të këtyre kompanive"- u shpreh zëvendësministri.

"Ky panair do nxjerrë në pah punën e të gjithëve, fakti që pjesëmarrëse janë edhe institucionet shtetërore e bën më të suksesshëm sepse gjithmonë e më shumë duhet të jemi më pranë njëri tjetrit për të ndihmuar këtë sektor. Bashkia i ka dedikuar një fokus të veçantë bujqësisë nëpërmjet projekteve dhe financimeve për produkte të blegtorisë bujqësisë si dhe industrisë përpunuese" - u

(Vijon në faqen 10)



për çdo fermer dhe të interesuarit e këtij sektori.

Në Agrotech Expo 2022 marrin pjesë kompani nga vende të ndryshme si Kosova, Maqedonia e Veriut Greqia, Italia Serbia si dhe nga Gjermania.

Në ceremoninë hapëse drejtoresha ekzekutive e Exposita Albania, Aulona Hoxha, u shpreh se numri i madh i sten-

tori"- u shpreh Hoxha.

Përfaqësues të institucioneve shtetërore si nga Ministria e Bujqësisë, Bashkisë etj., vlerësuam organizimin e këtij panairi dhe inkurajuan kompanitë pjesëmarrëse për sa më shumë bashkëpunim.

Andi Seferi zv.kryetari i Bashkisë së Tiranës u shpreh se ky panair do të nxjerrë në pah

SHQIPËRIA MERR PRESIDENCËN E BORDIT DREJTUES TË CIHEAM

MINISTRJA E BUJQËSISË SË SHQIPËRISË, FRIDA KRIFCA ZGJIDHET PRESIDENTE E BORDIT DREJTUES TË QENDRËS NDËRKOMBËTARE PËR STUDIME TË AVANCUARA AGRONOMIKE MESDHETARE

Delegacionet e 13 shteteve anëtare të organizatës, në mbledhjen e 151-të që u mbajt në Institutin Oqeanografik të Parisit (Francë) përzgjedhën kandidaten nga Shqipëria, Frida Krifca që do të jetë gruaja e parë në krye të Bordit Drejtues të CIHEAM pas 60 vitesh. Ministria Krifca me veprimtarinë e saj në fushën e bujqësisë ka marrë besimin për të vazhduar edhe më tej përpjekjet e organizatës në zhvillimin e sektorit

Përgatitën: Pandeli Pasko (CIHEAM Bari), Francesco Ceglie (Koordinator i Projektit SAFIAL – CIHEAM Bari)

Ngjarja

Zgjedhja më 18 nëntor 2022, e Znj. Frida Krifca, Ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si Presidente e Bordit Drejtues të CIHEAM-it (Qendra Ndërkombëtare e Studimeve të Larta Agronomike Mesdhetare) është një ngjarje e rëndësishme si për bujqësinë në Shqipëri, ashtu edhe për vetë këtë Qendër Ndërkombëtare, për institucionet që e përbëjnë dhe për vendet anëtare të saj.

Për Shqipërinë, pasi në 30 vjetorin e anëtarësimit të saj në CIHEAM, ajo merr kreun e kësaj organizate dhe madje duke vendosur në krye të saj autoritetin më të lartë të vendit për bujqësinë. Ky pozicion do të lejojë patjetër rritjen e vëmendjes ndaj Shqipërisë dhe vendeve të tjera të Ballkanit, të cilat, në kuadrin e ish-Jugosllavisë, kanë qenë madje vend themeltar i CIHEAM-it.

Për CIHEAM dhe për 4 institucionet që e përbëjnë si dhe për 13 vendet anëtare, pasi për herë të parë në historinë e vet 60-vjeçare ka një grua Presidente. Ky aspekt bëhet edhe më i rëndësishëm në kuadrin e vendeve anëtare, të cilat përfshijnë gati të gjitha vendet që lagen nga Deti Mesdhe dhe të cilat kanë shtrirje në tre kontinente.

Aktualisht President i Bordit Drejtues të CIHEAM Bari është Z. Mohamed Sadiki (Marok) dhe Sekretar i Përgjithshëm është Z. Placido Plaza (Spanjë). Zgjedhjet e drejtuesve të bordit bëhen një herë në 4 vjet.



CIHEAM dhe roli i tij në bujqësinë mesdhetare dhe ndërkombëtare

CIHEAM – Centre International de Hautes Études Agronomiques Méditerranéennes) është një organizëm ndërkombëtar i cili përbëhet nga katër Institute Agronomike Mesdhetare (IAM-e): në Bari (Itali), Kania (Greqi), Montpelie (Francë) dhe Saragosë (Spanjë). Sekretariati i Përgjithshëm e ka selinë në Paris. (Skeda 1)

CIHEAM u ngrit me nismën e OECD dhe Këshillit të Europës më 21 maj 1962, bazuar në një marrëveshje mes 7 vendeve të Europës jugore: Francë, Greqi, Itali, Jugosllavi, Portugali, Spanjë e Turqi. Hapja ndaj brigjeve jugore e lindore të Mesdheut solli pranime të reja: Tunizi (1985), Egjipt dhe Algjeri (1986), Maltë (1989), Marok (1991), Shqipëri (1992) dhe Liban (1994). Pavarësisht kësaj shtrirje të vendeve anëtare, veprimtaria e 4 instituteve të tij i kalon kufijtë e 13 vendeve anëtare dhe në kohë ka përfshirë mbi 40 vende të tjera.



Fort i pranishëm historikisht në kooperimin shumëpalësh në fushat e trajnimit, rritjes së kapacitetit drejtues dhe kërkimit shkencor, CIHEAM-i punon me administratat publike, universitetet qendrat kërkimore, kooperimin dhe zhvillimin organizmave të ndryshme, komunitetet, shoqërinë civile dhe të biznesit për të plotësuar nevojat e popullsisë dhe territoreve të Mesdheut.

Misioni i CIHEAM-it për Mesdheun synon mbërritjen e objektivave të identifikuar si CAPMED 2025 “sigurimin e kualifikimit të mëtjeshëm (ekonomik dhe teknik) dhe krijimin e frymës së kooperimit ndërkombëtar

Vendet anëtare të CIHEAM-it



Presidentja e re me familjen e projekteve të CIHEAM Bari në Tiranë – nëntor 2022
Në qendër Presidentja e Bordit Drejtues të CIHEAM Znj. Frida Krifca dhe Sekretari i Bordit Drejtues të CIHEAM Z: Teodoro Miano

Agjenda Strategjike e CIHEAM 2025 dhe Plani i Veprimit i saj synojnë zbatimin e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, të Kombeve të Bashkuara në Mesdhe në fushat specifike.
(Shiko tabelën në fund të fq 5)


Shqipëria, institutet e CIHEAM dhe roli i veçantë i CIHEAM Bari-t në bujqësinë e tranzicionit

Në vitet '70-'80, në kushtet e izolimit totalitar të Shqipërisë CIHEAM, me një institut kaq pranë Shqipërisë si CIHEAM Bari, ishte thjesht një “mollë e ndaluar”, ashtu si shumë institucione perëndimore të njohura në fushën e kualifikimit profesional në bujqësi



dhe në fusha të tjera. Shqipëria u bë anëtare e CIHEAM-it më 1992 dhe ceremonia e pranimit u krye pranë CIHEAM Bari. (Foto në vijim)

Ky anëtarësim i bëri Shqipërinë partner aktiv të CIHEAM-it dhe i hapi rrugë specialistëve shqiptarë të ndjekin kurse të ndryshme pranë 4 institucioneve të CIHEAM-it me përfitime të konsiderueshme për kualifikimin e një brezi të tërë specialistësh, një pjesë e të cilëve edhe sot e kësaj dite kontribuojnë në pozicione të rëndësishme të Ministrisë së Bujqësisë, Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe në institucione të tjera. Po ashtu u zbatuan projekte të ndryshme dypalëshe dhe shumëpalëshe të financuara nga qeveritë e vendeve ku operojnë institutet e CIHEAM si dhe nga fonde të ndryshme ndërkombëtare dhe të zbatuara nga CIHEAM Bari (Itali), CIHEAM Kania (Greqi),



bëtar mes punonjësve drejtues të bujqësisë të vendeve Mesdhetare”, nëpërmjet studimeve pasuniversitare të specializuara, punës kërkimore dhe inovimit, netuorkeve dhe platformave të hapura për rritjen e dijeve në fushën e bujqësisë, projekteve dhe asistencës teknike dhe zhvillimit të dialogut politik dhe partneriateve. (Skeda 2)

Çdo institut mbulon fusha të caktuara kualifikimi pasuniversitar me kohë të plotë (1 ose 2-vjeçare në përputhje me, të cilat përfundojnë përgjithësisht me teza master si dhe kualifikime në shumë kurse të tjera të shkurtra 1 dhe 2-javore, përveç projekteve të shumta të kooperimit

Pranë instituteve çdo vit mesatarisht 400 studentë ndjekin kurse të ndryshme me kohë të plotë me bursa studimi falas dhe rreth 1000 të tjerë ndjekin kurse të ndryshme të shkurtra në këto institute. Si rezultat, vetëm në 10 vitet e fundit janë trajnuar mbi 12 000 studentë dhe ekspertë dhe aktualisht CIHEAM zbaton mbi 150 projekte kooperimi.

Po ashtu CIHEAM-i ka organizuar 11 takime ministeriale për të promovuar dialogun politik mbi çështje bujqësore dhe të zhvillimit rural në Mesdhe.

Në fushën e studimeve pasuniversitare të 4 instituteve të CIHEAM-it ofrojnë 20 Kurse Master të ndryshme në 5 fusha kryesore të bujqësisë dhe zhvillimit rural, duke kontribuar për zbatimin e Agjendës strategjike 2025 për Mesdheun.

- Ekonomi, menaxhim dhe zhvillim i zonave rurale
- Menaxhim i mjedisit dhe burimeve natyrore
- Siguri ushqimore, të ushqyerit dhe ushqimet e sigurt
- Sistemet Inovative të prodhimit bujqësor
- Peshkim dhe akuakulturë të qëndrueshme

Për Programet Master CIHEAM-ika përshtatur struktura dhe rregulla të cilat përbushin kërkesat e procesit të Bolonjës, duke përdorur sistemin ECTS (European Credit Transfer System) dhe dhënie të një Diplome Suplementare.

Në vijim Plani i Veprimit i CIHEAM-it për Mesdheun – CAPMED.
(Shiko skemën në fund të fq. 5)

Skedë: Aktivitetet e CIHEAM bazohen në parimin e bashkëpunimit nga baza në qendër dhe të orientuara për ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE lidhur me nevojat specifike të vendeve anëtare.

Misionet e CIHEAM mbështeten në 4 shtylla për zhvillim dhe në 15 përparësi tematike.



CIHEAM Montpellier (Francë) dhe CIHEAM Saragosa (Spanjë).
Një kontribut të veçantë në këtë drejtim ka dhënë CIHEAM Bari, i cili kryen mbi 70 % të aktiviteteve të CIHEAM-it dhe i cili ndodhet veç 100

Program i përbashkët me Gjermaninë për bujqësinë! MBZHR: Nis në janar, ndihma për fermerët Ministrja Krifca - Ozdemir: Gjermania shpreh angazhim për të mbështetur bujqësinë shqiptare

Me ftesë të ministres së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, zhvilloi në vendin tonë për një vizitë zyrtare ministri gjerman i Bujqësisë dhe Ushqimit Cem Özdemir.

Të deklaruar për shtyp, të dy ministrat ndanë lajmin se, nga janari në vendin tonë nis programi i përbashkët me Gjermaninë për zhvillimin e zonave rurale. Projekti gjer-

Ballkanin Perëndimor, Bashkimi Europian nuk është i plotë.

Gjermania është një partner kryesor për zhvillimin e një bujqësie të qëndrueshme, produktive, me standarde të larta të cilësisë, mbrojtjes së ambientit dhe garantimit të sigurisë ushqimore”, tha ministrja.

Më tej ministrja, tha se pjesë e diskutimit ishte dhe zhvillimi i strategjisë kombëtare

Ministri Cem Özdemir gjatë konferencës u shpreh se, “ky është udhëtimi i parë në Shqipëri dhe në Ballkanin Perëndimor. Më lejoni t’ju them në emër të Gjermanisë se Shqipërinë duam ta kemi anëtare me të drejta të plota të BE-së. Vlerësojmë çka keni arritur në mandatin e Këshillit të Sigurimit. Ju jemi mirënjohës në pozicionin që ju mbani në dënimin e agresionit të pajustificuar të Rusisë ndaj Ukrainës. Kjo është me shumë rëndësi, për shkak se vendi juaj, BE dhe Gjermania, janë 100% dhe ndajnë të njëjtin qëndrim në politikën e jashtme dhe e bëjnë bashkëpunimin tonë në fushën e bujqësisë më të mirë”.

Ai theksoi se, “pjesë e bashkëpunimit tonë është që ne duhet të ndihmojmë fermerët tanë të përditësohen në këto kohë sfidash. Vendet tona ndajnë të njëjtat sfida, patëm pandeminë, aktualisht kemi krizën e klimës, etj., dhe të gjitha këto mund të trajtohen nëse bashkëpunojmë”.

Ai ndër të tjera vlerësoi edhe punën e zhvilluar nga Ministrja e Bujqësisë Frida Krifca. “Ka qenë një ambasadoreshë për bujqësinë dhe interesat e fermerëve shqiptarë në Gjermani dhe Bashkimin Europianë. I lumtur të bashkëpunoj”, theksoi Özdemir.

Temë e diskutimeve mes dy ministrave ishte edhe rritja e shkëmbimit tregtar dhe investimeve të përbashkëta në fushën e bujqësisë. Vizita e Özdemir në Tiranë, vjen pas takimeve të mbajtura më parë në Gjermani, në kuadër të procesit të Berlinit.

Gjatë kësaj vizite ministri dhe ekipi i tij do të kenë një axhendë të ngjeshur në terren me fermerë, agropërpunues, shefa kuzhine dhe studentë të Universitetit Bujqësor të Tiranës.



man, i mbështetur nga GIZ synon mbështetjen e fermerëve dhe agropërpunuesve.

“Jemi këtu për të çuar përpara një histori të shkëlqyer bashkëpunimi mes Gjermanisë dhe Shqipërisë. Ai tashmë ka provuar që është një mik i vërtetë i Shqipërisë dhe gjithë Ballkanit Perëndimor”, tha ministrja, gjatë konferencës së përbashkët për shtyp me ministrin Federal të Gjermanisë për Bujqësinë dhe Ushqimin, Cem Özdemir.

Ministrja Krifca vuri në dukje se Gjermania është një partner kryesor për zhvillimin e një bujqësie të qëndrueshme.

“Vizita e Ministrit Özdemir, vjen pas konferencës së Procesit të Berlinit ndërmjet Bashkimit Europian dhe 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor, ku u ritheksua edhe një herë nga Kancelari Olaf Scholz se pa

7-vjeçare të bujqësisë.

“Diskutuam gjerësisht mbi të gjithë gamën e bashkëpunimit në fushën e bujqësisë nga zhvillimi i strategjisë kombëtare 7-vjeçare të bujqësisë, deri tek zhvillimi i një programi të ri ndihme për zhvillimin bujqësor dhe zonave rurale e ndikim të drejtpërdrejtë tek fermerët, blegtorët dhe agropërpunuesit në vend, të cilin do të fillojmë ta zbatojmë prej muajit janar”, u shpreh Krifca.

Ministrja i shprehu mirënjohjen homologut gjerman për vëmendjen e veçantë të qeverisë së tij, jo vetëm ndaj Shqipërisë, por edhe ndaj rajonit, ku Gjermania, theksoi ministrja, mbështet fuqishëm grupin e përbashkët të punës për zhvillimin e zonave rurale në Evropën Juglindore, presidencën e të cilës këtë vit e ka mbajtur Shqipëria.

Shqipëria dhe Sllovenia, programe të përbashkëta në fushën e bletarisë

Shqipëria dhe Sllovenia synojnë zgjerimin e bashkëpunimit në fushën e bujqësisë.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca zhvilloi një takim me ministrin e Bujqësisë të Sllovenisë Irena Šinko, gjatë vizitës që zhvilloi të enjten në Beograd, ku diskutoi për bashkëpunim të shtuar mes dy vendeve në sektorin rural.

Krifca tha se bashkëpunimi në bujqësi mes dy vendeve ka prioritet edhe për shkak të ngjashmërisë së strukturës me ferma të vogla, si dhe programeve të përbashkëta në fushën e bletarisë dhe angazhimin e rinisë në bujqësi si sfidë aktuale edhe për vendet europiane.



Krifca në Shtabin e Emergjencave Shkodër: Hidrovorët në funksion, vijojmë gatishmërinë

Moti me reshje shiu intensive që ka përfshirë vendin tonë ditët e fundit, ka krijuar problematika në zonën e Shkodrës. Përballë kësaj situatë, ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, bashkë me zv.ministrin Dhimo Kote dhe grupin e specialistëve inspektoi në orët e para të mëngjesit të së dielës, investimin në argjinaturën e lumit Buna, teksa u ndal dhe monitoroi punën në dy hidrovorët kryesorë të rajonit të Shkodrës.

Krifca tha se në hidrovorin e Velipojës, ekipet janë në gjendje gatishmërie. “Aktualisht, këtu grumbullohet uji me një shpejtësi prej 15m/s. Ky hidrovor është i rëndësishëm për 240 ha toka bujqësore, por edhe zona të banuara. Kemi verifikuar që të ketë një energji të pandërprerë nga OSHE. Të gjithë drejtoritë e Ujitjes dhe Kullimit janë në dispozicion dhe në gatishmëri për të përbaluar së bashku një mot të paqëndrueshëm me reshje të mëdha”, tha ajo. Gjithashtu ministrja inspektoi nga afër edhe hidrovorin e Çasit, Velipojë i cili është tejet i rëndësishëm për tërheqjen e ujit nga fusha e Çasit me 1500 ha të mbjella me foragjere e me grurë të cilat vihen në veshitësi për shkak të reshjeve. “Hidrovori është në funksion të plotë. Ekipet janë këtu duke punuar. Katër pompat janë aktualisht në dispozicion duke tërhequr ujin. Nuk shohim asnjë situatë të rënduar. Kapaciteti i tyre është 15

m3 në sekond, puna vazhdon me ritme dhe do jemi në monitorim për ta mbajtur nën kon-

situata vazhdon të jetë nën kontroll”, tha Krifca.

Ministrja informoi se bash-



troll. Argjinatura është në funksion të plotë”, theksoi Krifca.

Ministrja në takimin që zhvilloi mbrëmjen e së dielës me Shtabin e Emergjencës në zyrën e prefektes së qarkut Shkodër, Majlinda Angoni, mbi situatën e shkaktuar nga reshjet në këtë qark, deklaroi se ekipet e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit dhe strukturat përkatëse janë në terren dhe gatishmëri të plotë nonstop, për menaxhimin e situatës së krijuar. “Të gjitha strukturat tona të emergjencës janë në krye të detyrës ditë-natë, duke ndjekur nga afër situatën në terren për shkak të reshjeve të dendura të shiut dhe për të përcjellë në çdo moment informacion të saktë për qytetarët. Nga monitorimet e të gjithë hidrovorëve dhe kanaleve kul-luese në qarkun e Shkodrës ku

kisë së Vaut të Dejës, i është vënë në dispozicion një ekskavator për një ndërhyrje në zonë, teksa theksoi: “Të gjitha mjetet që kemi në dispozicion janë në gatishmëri për çdo situatë që paraqitet”.

Krifca tha se, kemi marrë masa dhe janë në gatishmëri të plotë edhe Drejtoritë e Veterinarisë, nëse do të ketë nevojë për lëvizjen e blegtorisë, apo për të asistuar blegtorët në rast nevojë.

Në mbledhjen e Shtabit të Emergjencës, ku ishin të pranishëm përfaqësues nga të gjitha institucionet e linjës, ministrja tha se Prefektura dhe pushteti lokal janë në bashkëpunim dhe në bashkërendim të punëve për të përbaluar me kurajo çdo situatë që paraqitet nga moti me reshje të dendura.

Modelet e zhvillimit socio-ekonomik për zonat rurale

EMA në bashkëpunim me Slovak Foreign Policy Association me kontributin e Këshillit të

aktorë të ndryshëm në funksion të integritimit europian duke cilësuar me rëndësi rritjen e shkëmbimit

dixhitalizimi; financimi si dhe përmirësimi i legjislacionit e përafrimi me atë të BE-së. Eksperti sllovak Ján Baršváry solli më afër rastin e Sllovakisë për sa i përket zhvillimit rural dhe shpjegoi përdorimin e pesticideve në bujqësinë organike bazuar në rregulloren e BE-së dhe ndryshimet që pritet të ndodhin duke dhënë rekomandime dhe për strategjinë që po hartohet në Shqipëri.



Agrobiznesit Shqiptar dhe me mbështetjen financiare të SlovakAid po zhvillon në Vlorë sessionin e tretë të Grupit të Punës III. Ky aktivitet fokusohet te modelet zhvillimit socio-ekonomik për zonat rurale (Projekti pilot “Oazi Ekologjik i Butrintit”) dhe përdorimi i pesticideve në bujqësinë organike. Arian Jaupllari Zv/Ministër i Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural u shpreh se ministria mbështet format e bashkëpunimit dhe rritjen e kapaciteteve në sektorin e zhvillimit rural. Ai vlerësoi pozitivisht përafrimin e legjislacionit me Acquis e BE-së dhe shtoi se po identifikohen modelet më të mira të fermave në të gjithë Shqipërinë për të përfutur nga skemat mbështetëse financiare, si fondet e AZHBR dhe IPARDIII që fillon në janar 2023. Ervis Moçka, Kryetar i Këshillit të Qarkut Vlorë tregoi gatishmëri për mbështetje e bashkëpunime me



të eksperiencave me Sllovakinë dhe vende të ngjashme. Aulona Beqiri Veizi, N/Kryetare e Bashkisë Vlorë theksoi se në Vlorë ka një mbizotërim të vreshtarisë dhe nevojitet një shkallë më e madhe certifikimi për produktet bio. Veizi tha se projekti Pilot “Oazi Ekologjik i Butrintit” ka objektiva interesante dhe duhet të zbatohet dhe në Vlorë. Agim Rrapaj, Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH) shpjegoi hapat për zbatimin e projektit pilot duke filluar nga bashkëpunimi dhe koordinimi; inovacioni dhe

Konventa Kombëtare për Integritimin Europian po zbatohet nga EMA në bashkëpunim me SFPA dhe mbështetjen financiare të SlovakAid. Konventa fokusohet në 3 drejtime kryesore: 1) rritja e pjesëmarrjes së të gjithë aktorëve dhe grupeve të interesit; 2) institucionalizimi i debatit publik në çështjet e BE-së bazuar në bashkëpunimin mes institucioneve publike dhe aktorëve jo-shtetërorë dhe 3) forcimi i kapaciteteve në negociatat për integritimin në BE përmes transferimit të njohurive sllovaqe.

Ministrja e Bujqësisë së Shqipërisë Frida Krifca zgjidhet Presidente e Bordit Drejtues të Qendrës Ndërkombëtare për Studime të Avancuara Agronomike Mesdhetare

(Vijon nga faqja 3)


km det pranë Shqipërisë. CIHEAM Bari ka kontribuar për zhvillimin e disa sektorëve si mjedisi, turizmi, hallkat e prodhimit bujqësor, bujqësia e integruar dhe ajo biologjike, zonat bregdetare, puna kërkimore dhe inovacionet, siguria ushqimore, rritja e kapaciteteve teknike e drejtuese, shërbimet këshillimore.

Afërsia dhe ngjashmëritë klimatiko-gjeografike, historike, kulturore, të biodiversitetit, etj. kanë mundësuar bashkëpunimin në fusha të ndryshme si gjendja e biodiversitetit, përcaktimi i grupeve lokale të interesuara, identifikimi i një sërë praktikash të mira teknologjike për kultura të ndryshme tradicionale, studimi i trashëgimisë historike, kulturore të zonave bregdetare dhe të brendshme të vendit, siguria ushqimore, mbrojtja e bimëve, certifikimi i materialit mbjellës dhe shumëzues, rritja e prodhimit, menaxhimi i burimeve natyrore, i mjedisit dhe i tokës.

Në të ardhmen bashkëpunimi do të shtrihet më tej në inovacionet e zbatuara për rritjen e vlerave të prodhimeve për tregun e brendshëm, në promovimin e ushqimeve tipike, në mbrojtjen e zonave bregdetare, në peshkimin e qëndrueshëm, në rritjen e rolit të grave, ristrukturimin e ekonomive mbas pandemisë, etj. (Skeda 3)

CIHEAM Bari ka hapur përvit kurse pasuniversitare 1 e dyvjeçare Master ku kanë marrë pjesë 85 studentë shqiptarë si vijon:

- Menaxhimi i tokës dhe i burimeve ujore: bujqësia nën ujë (Land and water resources management: irrigated agriculture - LW)
- Mbrojtja e integruar e pemëve frutore mesdhetare (Integrated pest management of Mediterranean fruit trees - IPM)
- Bujqësia biologjike mesdhetare (Mediterranean organic agriculture - MOA)
- Bujqësia e qëndrueshme (Sustainable agriculture)
- Inovimet e Hapura & Ndërmarrjet e të Rinjve në Sektorin Agrorimor Mesdhetar (Open Innovation & Youth Entrepreneurship in the Mediterranean Agrofood Sector - I&YE)
- Zhvillimi i qëndrueshëm i komuniteteve bregdetare (Sustainable development of coastal communities)



Nga 28 studentë të cilët kanë marrë gradën MSc, 7 prej tyre janë mbështetur edhe për mbrojtjen e doktoraturës PhD. Përfshirë kushtet e shumta të shkurtra në kuadër të projekteve të ndryshme, në kurset e CIHEAM Barit në Itali dhe në Shqipëri janë kualifikuar mbi 500 specialistë shqiptarë.

Disa nga aktivitetet më të spikatura në Shqipëri, ku ka marrë pjesë CIHEAM Bari ose të organizuara në kuadër të projekteve të zbatuara nga ky institut janë si vijon:

- Marrëveshja ndërmjet Ministrisë Shqiptare të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, CIHEAM Bari dhe Universitetit "A. Moro" Bari - Tiranë, 5 korrik 2022
- Paraqitja e ligjit të ri për bujqësinë biologjike nga Projekti BIO.RE.GOAL në forumin "Bujqësia Biologjike si sfidë dhe mbështetje e rëndësishme për Agroturizmin dhe zhvillimin Rural në Shqipëri", Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 16 qershor 2022
- Paraqitja e projektit BIOREGOAL në aktivitetet e lidhura me KEP (Platforma e Shkëmbimit të Dijes)- Tiranë, 18 maj 2022
- Forumi i 7-të EUSAIR, Strategjia "Farm to Fork" si çelës për transformimin e sistemit agorimor në vendet EUSAIR - Tiranë, 17 maj 2022

• Marrëveshja ndërmjet Ciheam Bari - Universiteti "A. Moro" të Barit - Universiteti i Vlorës, Universiteti i Durrësit - Universiteti i Korçës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës - Tiranë, 5 korrik 2022

- CIHEAM Bari/Bashkia Tiranë – Bashkëpunim për Politikën Ushqimore Urbane të Tiranës (Projekti FOODSHIFT) – Tiranë, korrik 2022
- Seminar ndërkombëtar "Universitetet e së ardhmes" me Ministrinë e Bujqësisë, Ministrinë e Arsimit, AICS, Ambasada e Italisë, Ciheam Bari, Universiteti "A. Moro" të Barit, Universiteti i Vlorës, Universiteti i Durrësit, Universiteti i Korçës dhe Universiteti i Bujqësisë Tiranë-Tiranë, 1 Dhjetor 2021
- Takime për "Living Lab për të bashkëprojektuar zyrën e transferimit të teknologjisë" Universiteti i Vlorës, Universiteti i Durrësit, Universiteti i Korçës dhe Universiteti Bujqësor Tiranë, Janar - Dhjetor 2021
- Konferenca e 1-rë Ndërkombëtare "Bioteknologji & Gjenetikë" në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, 20-21 Maj 2021
- Konferenca e 2-të Ndërkombëtare në Bujqësi, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, 6-8 maj 2018
- Ditë Agro-Studimi - në Universitetin Bujqësor të Tiranës, 1-2 Mars 2018
- Konferenca e 1-rë Ndërkombëtare për Tokën në Universitetin Bujqësor të Tiranës, 4-6 Maj 2015
- Vazhdimësi e IAMB "Bujqësia, mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm - 15 vjet bashkëpunim i CIHEAM në Shqipëri", Tiranë, 22 maj 2008
- Uorkshop "Paraqitja e rezultateve përfundimtare të projektit për përhapjen dhe asistencën teknike për zbatimin e metodave për prodhimin e produkteve biologjike (PAB)", Tiranë, 20 mars 2007
- Panairi "Agrobiznes 2006", Tiranë, 29 shtator - 2 tetor 2006
- Seminar mbi ullishtarinë biologjike, Tiranë, 6 dhjetor 2005.
- Uorkshop "Rezultatet e para të projektit PAB mbi bujqësinë biologjike", Panairi bujqësor i Tiranës, 30 Prill 2005
- Konferenca "Bashkëpunimi italo-shqiptar në bujqësinë biologjike", Tiranë, 14 tetor 2004.
- Konferenca "Degradimi dhe mbrojtja e tokës në Shqipëri", Tiranë 22-23 Prill 2003
- Konferenca "Festimi i Ditës së Tokës", Instituti i Tokave, Tiranë, 22 Prill 2002.
- Konferenca Ndërkombëtare "Politika mjedisore: instrument dhe metodë", Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër 5-6 dhjetor 2003
- Konferenca Kombëtare "Bujqësia dhe shkencat bujqësore nga tranzicioni në integrimin European", Universiteti Bujqësor i Tiranës, 31 Tetor 1 Nëntor 2002.
- Simpoziumi Shkencor "Realitete dhe perspektiva të pentarisë në Shqipëri", Vlorë, 12 Mars 1996

- si dhe
- Ngritje dhe mirëmbajtje e stacionit hidrometeorologjik të Universitetit Bujqësor të Tiranës
- Dhurim abonimesh vjetore për 15 revista shkencore dhe materiale bujqësore për Ministrinë e Bujqësisë, Institutin e Mbrojtjes së Bimëve, Institutin e Pemëve Frutore dhe Ullirit
- Dhurim i mbi 500 librave Bibliotekës së Universitetit Bujqësor të Tiranës (pas vitit 1997)



Nënshkrim i marrëveshjes me Ministren e Arsimit



Bashkëpunimi Ministria e Bujqësisë dhe Kooperimi italian (AICS Tiranë)



Ambasadori italian

Bashkëpunimi i ngushtë dhe financimet e projekteve kryesisht nga Kooperimi italian, i ka lejuar CIHEAM Barit të marrë pjesë, së bashku me institucione shkencore të tjera italiane dhe në veçanti nga Pulia, në pro-

cesin e harmonizimit të standardeve dhe në përshtatjen e ligjeve duke bashkëpunuar me departamente të ndryshme të ministrive të Bujqësisë dhe asaj të Mjedisit, lidhur me negociatat për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian. Po ashtu është dhënë mbështetje për hartimin e ligjeve të bujqësisë biologjike dhe planit kombëtar të veprimit dhe për trajnime për specialistët e shërbimit këshillimor të Ministrisë së Bujqësisë.

Aktualisht po zbatohet projekti për "Forcimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për menaxhimin e sigurisë ushqimore" (SA-FIAL), "Zgjerim i kornizës ligjore për prodhimin e ushqimeve biologjike në Shqipëri" (BIO.RE.GOAL), "Transferimi i mjetshëm i teknologjive në sektorin e ushqimit duke forcuar zyrat e transferimit të teknologjive në Universitetet shqiptare" (TTO\$FOOD_ERASMUS).

Ndërkohë sapo kanë përfunduar projektet "Mbështetje institucionale për zhvillimin e ekonomisë detare dhe bregdetare" (Mar.E.), "Zhvillimi i qëndrueshëm të sektorit të ullirit në Shqipëri" (ASDO), "Modeli pjesëmarrës për menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve detare dhe bregdetare dhe për habitatet ndërkufitare dhe ruajtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve" (BLUE LAND), "Bashkëpunimi ndërkufitar për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit nëpërmjet vlerësimit të trashëgimisë kulturore rurale dhe ruajtjes së zonave natyrore me ullishta shekullore" (CBO), "Forcimi i netoerve për përmirësimin e lidhjes midis punës kërkimore dhe NVM" (FILA). Dy të fundit janë projekte Interreg mes Italisë, Shqipërisë dhe Malit të Zi dhe kanë marrë vlerësim të veçantë nga qeveria italiane.

Në veprimtaritë e kooperimit partneri kryesor ka qenë Ministria e Bujqësisë dhe institucionet kërkimore të saj, sidomos qendrat e shpërndarjes së teknologjive bujqësore në Vlorë, Korçë, etj. Partnerë të tjerë janë: Ministria e Mjedisit, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti i Studimeve i Tiranës, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, prefektura, komuna, Këshilli i Agrobiznesit (KASH), shoqata, etj.

CIHEAM Bari bashkëpunon me institucione të rëndësishme italiane, të vendeve të tjera dhe ndërkombëtare si Ministria Italiane e Punëve të Jashtme, FAO, Banka Botërore, GIZ, Rajoni i Pulies me provincat e saj, Universiteti i Barit, Universiteti i Leçes, CUM – Komuniteti i Universiteteve Mesdhetare, Qendra Kërkimore Eksperimentale Bujqësore – CRSA, Consorciumi i Fidanave, etj.

Janë botuar mbi 30 libra e manuale për çështje të ndryshme të bujqësisë shqiptare, shqip, anglisht, italisht dhe shpesh në version dygjuhësh dhe mbi 100 artikuj shkencorë në revista shkencore shqiptare, italiane dhe ndërkombëtare.


Përfundim

Perspektiva e bashkëpunimit të Shqipërisë me CIHEAM-in dhe me institutet e tij, sidomos me CIHEAM Bari-n, pritet të marrin një impuls të ri zhvillimor me kalimin e presidencës së Bordit Drejtues të CIHEAM ministres shqiptare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural edhe për faktin e njohjes së mirë të kësaj fushe nga ana e Znj. Ministre. Në këtë mënyrë Shqipëria nga një anë spikat në fushën ndërkombëtare, duke forcuar lidhjet me një institucion ndërkombëtar, me program të përafërt me atë të Bashkimit Europian dhe nga ana tjetër i hapen më shumë mundësi për zgjidhjen e problemeve të ndryshme të bujqësisë në këtë fazë të zgjatur dhe jo të lehtë tranzicioni. Po ashtu përbën edhe një

hap të rëndësishëm në kuadër të impenjimit për përshtatjen e legjislativitetit të BE-së në këtë fazë të negociatave për t'u bërë shtet anëtar i BE-së.

(Vijon në faqen 8)

PLANI I VEPRIMIT I CIHEAM PËR MESHHEUN



CAPMED 2025

15 PËRPARËSITË TEMATIKE
Mbrojtja e planetit "duke luftuar humbjet e trefishta"
<ul style="list-style-type: none"> • Shkëmbimi i njohurive dhe mbrojtja e dijeve tradicionale • Menaxhimi i burimeve natyrore dhe energjitike (uj, toka, pyjet, energjia, biodiversiteti, deti...) • Reduktimi i humbjeve bujqësore dhe ushqimore nëpërmjet gjithë hallkave të prodhimit të tij
Siguria Ushqimore dhe e të ushqyerit "duke zhvilluar fort bujqësinë dhe ushqimin e qëndrueshëm"
<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i dietës Mesdhetare • Rritja e mjetshme e përdorimit të praktikave agro-ekologjike • Përmirësimi ushqimeve të sigurta dhe cilësisë së tyre • Rritja e qasjes ndaj ushqimit
Zhvillimi përfshirës "duke investuar brezat e rinj dhe territoret e degraduara"
<ul style="list-style-type: none"> • Punësimi i të rinjve studimet afatgjatë • Zhvillimi i zonave rurale dhe bregdetare • Barazia gjinore dhe pjesëmarrja e grupeve të brishta • Emergjencat e territoreve rurale 'smart' dhe i modeleve përfshirëse bujqësore dhe të peshkimit (smart – zgjidhje me teknologji digjitale, me parteneriate mbështetëse, për zhvillim të qëndrueshëm dhe jetë më të mirë)
Krizat dhe aftësia përballuese dhe rindërtuese "duke kontribuar për menaxhimin e tensioneve"
<ul style="list-style-type: none"> • Lëvizja e popullatave dhe migrimet • Ndryshimet klimatike dhe dhe zgjidhjet për t'u përshtatur këtyre ndryshimeve • Shëndeti i kafshëve dhe i bimëve • Tregjet bujqësore

INFORMACIONE

Rigjallërim i liqenit të Shkodrës për mbarështimin e krapit

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në bashkëpunim me FAO-n synojnë rigjallërimin e Liqenit të Shkodrës përmes teknikave të mbarështimit të përdorura nga peshkatarët me përvojë tek peshkatarët e rinj.

Gjatë sezonit të riprodhimit në prill 2022, ekspertët e FAO-s punuan me peshkatarët për të ndërtuar rrethime të përkohshme rrjete për të mbështetur depozitimin e vezëve për mbarështimin e krapit që njihet si “mbreti i Liqenit të Shkodrës”.

“Ne kemi punuar me peshkatarët për të rikuperuar traditat e tyre dhe për t’i përdorur ato për të mbështetur praktikën e qëndrueshme duke krijuar mundësi që krijojnë vende pune, mbrojnë mjedisin dhe mbështesin jetesën në planin afatgjatë,” thotë Nicoletta Milone, oficer

e peshkimit në FAO.

Projekti AdriaMed përfshin gjithashtu plane për ngritjen e një çerdheje për të prodhuar një furnizim të besueshëm dhe të mjaftueshëm të vogëlshëve të peshkut dhe për të siguruar qëndrueshmëri afatgjatë në liqenin e Shkodrës.

Roland Kristo, zëvendësministër i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Shqipërisë, i cili është përgjegjës për peshkimin dhe akuakulturën, thotë se projekti tashmë ka dhënë rezultate dhe



se peshkimi i liqenit do të ketë një të ardhme.

“Ne besojmë fuqimisht se me një bashkëpunim të mirë dhe me përfshirjen e të gjithë aktorëve, ne mund të arrijmë zhvillimin e qëndrueshëm të peshkimit tonë dhe të sigurojmë menaxhimin e duhur të burimeve tona,” thotë Kristo.

Ndërsa Arben Kipi, ndihmëspërfaqësuesi i FAO-s në Shqipëri, thotë se kjo nismë luan një rol të rëndësishëm edhe në uljen e varfërisë, pasi përmirëson jetesën e peshkatarëve duke gjeneruar të ardhura më të qëndrueshme.

Nisma e projektit AdriaMed feston Vitin Ndërkombëtar të Peshkimit Artizanal dhe Akuakulturës (IYAFA 2022) i cili njihet dhe mbështet kontributin e peshkimit dhe akuakulturës artizanale në shkallë të vogël për zhvillimin e qëndrueshëm.

Pesticidet, kryefjala e certifikimit GlobalGAP!

Edita Dibra trajnere e licencuar nga GlobalGAP, në një prononcim për gazetën Agrobiznesi, tregoi se një nga problematikat kryesore që vihet re në terren, tek fermerët



është mungesa e informacionit që kanë ata në lidhje me listën e pesticideve të aprovuara për përdorim në sektorin e bujqësisë në Shqipëri. Sipas saj, kjo bën që fermeri të aplikojë edhe pesticide të palejuara, çka dëmton atë vetë dhe produktin që kultivon. Gjithashtu vuri në

dukje, ekspertja Dibra, një rol kyç luan edhe agronomi i cili duhet të orientojë fermerët në aplikimin e PMB-ve, të lejuara dhe që nuk pengojnë certifikimin GlobalGAP.

Prononcimi i plotë

Nga praktika ime në terren, si trajnere e licencuar nga GlobalGAP, vë re problematikat si pasojë e mungesës së informacionit që fermerët kanë në lidhje me ekzistencën e një liste pesticideve të aprovuara për Shqipërinë, e cila madje përditesohet 2 herë në vit. E fundit është ajo e muajit gusht 2022. Kjo bën që fermeri të aplikojë edhe pesticide të palejuara, çka dëmton atë vetë dhe produktin që kultivon, grosistin që i blen produktin si dhe e përjashton nga mundësia për t’u certifikuar GlobalGAP. Nga ana tjetër kemi farmacistë bujqësorë, të cilat edhe pse janë në dijeni të kësaj liste, kanë në stok edhe preparate që pavarë-

sisht se nuk lejohet të importohen më (sërisht pjesë e Listës së PMB-ve), gjendja aktuale që ata disponojnë duhet treguar në vend. Kjo gjithashtu bën ndesh me certifikimin GlobalGAP duke qenë se ky i fundit nuk i “njeh” këto preparate së të ligjshme për t’u aplikuar (EU Pesticides Database). Një rol kyç luan edhe agronomi i cili duhet të orientojë fermerët në aplikimin e PMB-ve, të lejuara dhe që nuk pengojnë certifikimin GlobalGAP. Nga ana tjetër, duhet të kemi parasysh që edhe kur pesticidi është i lejuar për përdorim në Shqipëri, duke qenë kështu pjesë e listës së aprovuar, duhet që në etiketën respektive të tij, të ketë të shkruajtur specifikisht kultivarin për të cilin është i lejuar përdorimi. Thënë këto, lista në vetvete nuk përbën problematikë në implementimin apo certifikimin GlobalGAP, por mungesa e informacionit dhe trajnimeve në lidhje me të, po.

Axhenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, Krifca: Shqipëria reforma konkrete

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca mori pjesë në takimin e Grupit të Përbashkët të punës për Zhvillimin e Zonave Rurale në Evropën Juglindore, që zhvilloi punimet në Budva, Mali i Zi.

Në këtë takim, Shqipëria u vlerësua maksimalisht në zbatimin e reformave konkrete në procesin e përafritimit me BE-në dhe Axhendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor.

Ministria Krifca tha se

“Shqipëria u vlerësua maksimalisht për udhëheqjen e punëve të Grupit të punës dinamikë dhe çuarjen përpara të bashkëpunimit rajonal duke ndjekur me dilijencë politikën bujqësore të përbashkëta me reforma konkrete në procesin e përafritimit me BE dhe Axhendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor”.

Takimi u finalizua me firmosjen e marrëveshjes së bashkëpunimit mes ministrave të

Ballkanit Perëndimor për një qasje të përbashkët për të ruajtur, mbrojtur dhe ushqyer tokën.

Grupi i Përbashkët i Punës për Zhvillimin e Zonave Rurale në Evropën Juglindore, me pjesëmarrjen e ministrave të Bujqësisë së këtyre vendeve, në prani të ministrit gjerman të Bujqësisë dhe Ushqimit Cem Ozdemir, që e mbështet fort këtë Grup, u mbledhën në Budva për të kaluar Presidencën nga Shqipëria tek Mali i Zi.

Këshillim në karrierë, RisiAlbania bashkëpunim me Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Bashkëpunimi mes Universitetit “Aleksandër Moisiu” dhe RisiAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, në fushën e orientimit dhe këshillimit në karrierë do të vijojë.

Rektorja Prof. Dr. Kseanela Sotirofski dhe Menaxherja e Projektit Edlira Muedini, nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi ku riafirmuan angazhimin për të konsoliduar dhe diversifikuar më tej shërbimet e ofruara nga Sektori i Karri-

erës dhe Alumnit në UAMD.

Marrëveshja, ndër të tjera synon:

- Mbështetjen për zhvillimin e vazhdueshëm të këshilltarëve të karrierës nëpërmjet trajnimeve në grup, aktiviteteve të shkëmbimit profesional me institucione jashtë Shqipërisë;

- Zhvillimin e një sistemi të brendshëm të menaxhimit të karrierës, për të promovuar automatizimin dhe digitalizimin e shërbimeve;

- Diversifikimin e shërbi-

meve të karrierës, duke zhvilluar më tej përmbajtjen dhe mjetet (digjitale dhe jo-digjitale);

- Organizimin e aktiviteteve promovuese të këshillimit të karrierës për të rritur ndërgjegjësimin e studentëve për këto shërbime.

UAMD është krenar për bashkëpunimin me RisiAlbania për këshillimin, orientimin profesional dhe fuqizimin e të rinjve, për të patur sukses në tregun e punës.

Krifca: 14% rritje të buxhetit për përballimin e ndryshimeve klimaterike

“Bujqësia ka nevojë për më shumë akses në financë nga sistemi bankar, por dhe të diversifikojmë burimet e financimit përmes instrument-

Financiare, Ambasada zvicerane dhe Banka Botërore, mbi mundësitë e financimit të gjelbër në Shqipëri.

Duke përgëzuar organiza-

që kanë të bëjnë me afrimin e bujqësisë me qëndrueshmërinë ekonomike dhe financiare duke konsideruar zhvillimin e një bujqësie të qëndrueshme përballë sfidave të ndryshimeve klimaterike”, tha ministria.

Ajo theksoi se, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka ndërmarrë këtë vit një strategji 7-vjeçare e cila është tërësisht në përputhje me objektivat zhvillimor të rëndësishëm që kanë të bëjnë me zhvillimin rural, ekonominë blu, sigurinë ushqimore, etj.

Krifca theksoi se, këto janë politika ambicioze që kanë nevojë për mjete financiare që nuk vijnë dot vetëm nga fondet publike. Ndryshimet klimaterike janë sfida të rëndësishme përballë sektorit bujqësor ndaj dhe kërkohet diversifikim i mekanizmave financiarë.

Sipas saj, në fokus të politikave që ka ndërmarrë MB-ZHR, është ulja e ndikimit të efekteve klimaterike si erozioni dhe përmytjet, ndaj dhe

(Vijon në faqen 7)



ve të ndryshëm financiarë me modele mikse që rrisin konkurrueshmërinë dhe efektivitetin për të plotësuar nevojat e sektorit për modernizim”.

Kështu u shpreh sot, ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, në konferencën e organizuar në Tiranë, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes

torët për këtë iniciativë. Krifca theksoi se, “bujqësia për vetë impaktin që ka në mjedis, zë një vend të rëndësishëm në ‘Axhendën e gjelbër’”.

“Liderët e Ballkanit Perëndimor në fund të 2020, kanë firmosur dokumentin e ‘Axhendës së gjelbër’, ku kanë ndërmarrë një sërë nismash



Skema Kombëtare në Bujqësi AZHBR

Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) po vijon kryerjen e pagesave, subvencion për fermerët e kualifikuar përfutues nga Skema Kombëtare e Mbështetjes për Bujqësinë 2022.

“Pagesa të kryera deri në datën 21 nëntor 2022, nga Skema Kombëtare e mbështetjes për bujqësinë, janë dhënë 3.8 miliardë lekë për 41 410 fermerët përfutues”, njofton AZHBR.

AZHBR ka mbështetur sektorët embarështimit të bletarisë, tufën bazë, fara/fidanë, ndërtimi i serrave, fermat organike, kultivimi i bimëve mjekësore, automatizimi dhe digitalizimi i



fermës, si dhe mbështetje me naftë për kryerjen e punimeve të mekanizuara në bujqësi, rinovi-

mi i infrastrukturës së anijeve të peshkimit dhe ngritja e tregjeve të produkteve bujqësore.

Cilat janë problematikat me PMB-të dhe me listat e tyre në zbatimin e GlobalGAP?

(Vijon nga faqja 2)

as të përdoret.

Realiteti tregon se kjo gjë deri tani, për vite me radhë, nuk bëhet dhe në pikat e tregimit të PMB-ve mund të gjenden pesticide me lëndë aktive të cilat janë të ndaluara prej disa vitesh. Lista më e re nr. 2, e gushtit 2022, përmban 73 PMB që nuk lejohen të importohen dhe BE nuk lejon përdorimin e tyre, megjithatë shumë prej lëndëve aktive të ndaluara të kësaj liste, si psh Thiocloprid, Chlorpyrifos, Imidacloprid, Myclobutanil, Dimethoate dhe Omethoate etj. gjenden ende në farmaceutikë bujqësore dhe tregtohen akoma. Ka jo pak raste, por le të përmendim disa prej analizave që janë kryer gjatë muajit tetor 2022, në laboratorë të akredituar me ISO 17025 në Itali (Euro Quality Lab) dhe në Shqipëri (Tenuis) me kampione të marra direkt nga serrat nga kompania Doni Fruits dhe OGL: në një kampion spec babur figuron mbetje e lëndës aktive Myclobutanil (fungicid i ndaluar), në një kampion mandarine figuron mbetje e Omethoate (insekticid i ndaluar që në janar 2021. Po kështu, mbetje të Chlorpyrifos, që ka vite që është ndaluar të përdoret, si edhe të Pyriproxyfen janë gjetur gjithashtu në një mostër tjetër mandarine. Rezultatet figurojnë në raportet e lëshuara nga laboratorët e sipërpërmendur. Sigurisht që kemi edhe shumë raste të analizave të produkteve të cilat dalin pa asnjë mbetje, pra janë krejtësisht të pastra, por qëllimi i shkrimit është të identifikohen problematikat me listat e PMB-ve dhe me përdorimin e atyre të cilat janë të ndaluara.

Një problem tjetër që vlen për t'u theksuar, është ai lidhur me mentalitetin e fermerit në përgjithësi. Ka fermerë të cilët kur bëjnë trajtim të bimëve, janë të fiksuar në përdorimin e vetëm të disa pesticideve që i kanë përdorur prej vitesh dhe nuk heqin dorë prej tyre edhe kur ato lënë mbetje. Sjellim shembullin e kungullit që kultivohet në një zonë të njohur për prodhimet në serra. Një numër fermerësh të kësaj zone përdorin për rritjen e frutit te kungullit hormonin 4-CPA prej disa vitesh. Ky është një hormon i cili lë mbetje dhe është konsideruar i dëmshëm. Analizat që kemi bërë herë pas here tregojnë prezencën e këtij hormoni dhe për këtë arsye klienti i Doni Fruits nuk e blen këtë produkt. Megjithatë u gjet dhe u ble një hormon tjetër i lejueshëm si alternative, Agibelin18 TB dhe ju propozua ta provojnë, fermerët nuk e pranuan. Madje jo vetëm ky grup fermerësh, por edhe të tjerë, nuk kanë një kuptim të qartë dhe të drejtë për dëmin që shkaktojnë substanca të tilla që lënë mbetje. Pra, mentaliteti i fermerit ka nevojë të ndry-

shojë. Fermerët duhet të jenë të hapur ndaj alternativave të reja. Por kjo kërkon **edukim dhe trajnime të programuara.**

Empirizmi në tregtimin e pesticideve është një problem tjetër që ndodh me farmaceutikë bujqësore. Jo të gjithë ata që shesin janë të kualifikuar në fushën e mbrojtjes së bimëve. Për rrjedhojë edhe “këshillat” që u japin fermerëve dhe PMB-të që rekomandojnë nuk janë ato të duhurat. Ka raste që ata nuk disponojnë as listat e PMB-ve, dhe kur i kemi ofruar listat e reja, përgjigja nga disa prej tregtarëve të inpleteve ka qenë: “Unë i di këto, s’ka nevojë...”. Gjithashtu ka pika të tregimit të inpleteve dhe pesticideve që shesin edhe produktet e listës së dytë (gjithsesi në njëfarë mënyre ata janë të mbrojtur nga fakti që “lejohen për t’u përdorur në RSH”) apo ato që janë hequr nga lista prej kohësh. Që të hiqen nga tregu produkte të tilla lind nevoja për ndryshime edhe në legjislacion.

Ndodh gjithashtu që **i njëjti produkt (PMB) dhe e njëjta lëndë aktive figuron në të dyja listat, edhe te e lejuara, edhe tek e palejuara.** Ky është një problem tjetër i cili krijon konfuzion. Konkretisht i referohemi listës më të re të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë në gusht 2022. Emri tregtar, emri i lëndës vepruese, klasifikimi dhe emri i kompanisë aplikuese janë të njëjtë:

Muligan-Pyriproxyfen-Insekticid-Proplan Plant Protection Company. Ky informacion figuron në të dyja listat, nr. 1 dhe nr. 2, por ndryshon data e regjistrimit, tek lista e lejuar është 29.04.2022 dhe te lista e palejuar është data 06.02.2017. Atëherë duhet që fermerit t’i shitet më e reja, që do të thotë është më e sigurt për bimën dhe shëndetin e njeriut. A ndodh kjo, apo shiten të dyja?

Ndryshimeve në listat e pesticideve të BE-së bëhen në bazë të vlerësimeve që bën EFSA dhe vendet anëtare të BE-së, duke pasur në fokus ndikimin që ka përdorimi i PMB-ve të caktuara në tre drejtime: në shëndetin e njeriut, në kafshët dhe në mjedis. Për ta ilustruar këtë, i referohemi legjislacionit europian. Rregullorja e Komisionit Europian (EC) 1107/2009, neni 10 thotë:

“Substancat (aktive) do të përfshihen në produktet për mbrojtjen e bimëve vetëm kur është demonstruar, që ato përfaqësojnë një benefit të qartë për mbrojtjen e bimëve dhe nuk kanë asnjë efekt të dëmshëm në shëndetin e njerëzve ose të kafshëve dhe asnjë efekt të pranueshëm në mjedis”.

Sot në të gjithë vendet e Bashkimit Europian tendenca është ajo e reduktimit të përdorimit të PMB-ve, e zvogëlimit të numrit të tyre. Edhe në vendin tonë, nëse lista nr. 1 e majit 2020 përmbante 339 PMB të lejuara, ajo është

reduktuar disa herë dhe lista më e re e gushtit 2022 përmban 320 të tilla, pra 19 më pak. Reduktimi i numrit të pesticideve ka si qëllim që konsumatori të gjejë në treg dhe të konsumojë në shtëpi produkte më të sigurta dhe më të shëndetshme. Por kjo gjë kërkon profesionalizëm në të gjitha hallkat e zinxhirit të ushqimit, kërkon monitorim të situatës së kultivimit në vazhdimësi, që nga mbjellja deri sa produkti të mbërrijë tek konsumatori, përdorimin me kriter të plehrave të certifikuar, bërjen e analizave të tokës, të ujit dhe të produktit, zbatimin e rregullave të higjienës së produktit dhe të punëtorëve, spërkatje me produkte të lejuara duke zbatuar dozën, karencën, qarkullimin bujqësor, zbatimin e rregullave të vjeljes dhe të pasvjeljes dhe gjurmueshmërinë e produktit.

Çështja e pesticideve dhe e Sigurisë Ushqimore sigurisht që është një çështje globale, probleme ka në shumë vende europiane, madje edhe të zhvilluara, prandaj kjo meriton vëmendje të veçantë.

Në shtator 2022, kompania konsultente gjermane AFC Risk & Crisis Consult publikoi një artikull me titull “Importi dhe eksporti i substancave të rrezikshme”. Në këtë artikull theksohet se në vitin 2021 nga Gjermania u eksportuan rreth 53,000 ton substanca aktive të mbrojtjes së bimëve, nga të cilat 8,525 ton ishin substanca aktive jo të miratuara në BE. Gjithashtu gjatë muajit shtator janë dedektuar edhe raste të fallsifikimit të ushqimeve, si mjalti në Hungari me origjinë të fallsifikuar, prodhime deti me mungesë dokumentacioni në Itali, vaj ulliri i fallsifikuar në Spanjë etj. Pra problemet e lidhura me PMB-të dhe me Sigurinë Ushqimore janë prezente edhe në vende të tjera të botës dhe ne nuk mund t’i shmangim plotësisht, por t’i zvogëlojmë. Kompanitë e mëdha shqiptare që importojnë inplete bujqësore, plehra dhe PMB duhet të kenë parasysh tendencën e zvogëlimit të pesticideve dhe në qendër të vëmendjes importimin e atyre PMB-ve që janë më cilësoret dhe të lejuara për t’u përdorur, pasi kjo ka lidhje direkt me shëndetin tonë dhe me mjedisin ku jetojmë dhe punojmë.

Edukimi dhe trajnimet e specializuara dhe efektive me agronomët, fermerët dhe specialistët e tjerë të fushës janë një instrument shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm.

Plani i Veprimit për përdorimin e qëndrueshëm të PMB-ve në Shqipëri i cili po hartohet, do të jetë një dokument i rëndësishëm kombëtar për vendosjen e rregullave të qarta në përdorimin e pesticideve, uljen e rrezikut që vjen nga PMB-të dhe për forcimin e sigurisë ushqimore, shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve dhe mbrojtjen e mjedisit.

Informacion mbi standardet e cilësisë në agroushqim

Ekspertët e fushës japin një informacion mbi standardet e cilësisë në sektorin e bujqësisë.

1. Çfarë është Local GAP?

Standardet po shtohen, si gjeografikisht ashtu edhe në aspektin adresimittëshqetësimi të reja. Një nga standardet më të rëndësishme private në sektorin e agroushqimit është localg.a.p. Përbushja e kërkesave të localg.a.p përfshin kalimin e disa pikave të kontrollit bazuar në sigurinë ushqimore, gjurmueshmërinë, qëndrueshmërinë mjedisore dhe shëndetin në punë të punëtorëve. Plotësimi menjëherë i të gjitha këtyre kërkesave, mund të mos jetë aq e lehtë për prodhuesit me burime të kufizuara dhe pengojnë aksesin në treg. Duke pasur në fokus shqetësimet e prodhuesve/shitësve të tregjeve dhe vendeve në zhvillim, është projektuar localg.a.p. Ai synon të ndihmojë prodhuesit të adoptojnë praktika të mira bujqësore që mund të përmirësojnë efikasitetin e menaxhimit të fermës, të zvogëlojnë ekspozimin ndaj rreziqeve të sigurisë ushqimore si edhe të pajtohen me legjislacionin për sigurinë ushqimore. localg.a.p janë standarde që bazohen në një vlerësim dhe nuk janë pjesë e certifikimit, por është rruga e duhur për të përgatitur prodhuesit për certifikim, veçanërisht ata që nuk mund të certifikohen menjëherë. Koncepti kyç i këtij standardi është ngritja e kapaciteteve dhe janë zhvilluar për zbatimin local. Gjithashtu, ky standard konsiderohet ura lidhëse për prod-

huesit që synojnë të eksportojnë duke u pajisur me standard GLOBALG.A.P. lokalg.a.p është i disponueshëm në nivele të ndryshme (nivele hyrës, themelues dhe i ndërmjetëm). Synimi përfundimtar është të përparohet drejt praktikave më të mira në nivel ferme. Në këtë mënyrë, prodhuesit mund të fillojnë në nivelin më të ulët dhe të përparojnë në nivelet e tjera më të larta kur të jenë gati.

2. Pse është e rëndësishme që eksportuesit duhet të investojnë së bashku me fermerët në Local GAP?

Në ditët e sotme, konsumatorët duan produkte bujqësore cilësore të garantuara, të prodhuara në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme. Standardi GLOBALG.A.P mund të përbushë kërkesat e konsumatorëve dhe mund të hapë dyert e eksportit, por është shumë i komplikuar dhe i vështirë për t’u implementuar nga fermeri ynë. Prodhuesit shqiptarë bujqësor përballen me sfidat e hyrjes në tregjet rajonale apo me tej, duke qënë se përbushja e këtyre kërkesave mund të jetë e vështirë si pasojë e mos përbushjes zyrtarisht të kërkesave të sigurisë ushqimore ose të kërkesave për t’u certifikuar sipas standardeve apo certifikimit GLOBALG.A.P. Duke pasur në fokus këto shqetësimet, është e rëndësishme që eksportuesit të investojnë me fermerët në localg.a.p duke qënë se ky standard është ura lidhëse për prodhuesit që synojnë të eksportojnë duke u pajisur me standard të njohur ndërkom-

bëtarisht GLOBALG.A.P. Njëpërmjet localg.a.p konsumatori mund të garantohet nga prodhuesi që produktet janë të gjurmueshme në fermë (prodhuesi duhet të regjistrojë datat e sakta të mbjelljes dhe vjeljes), mbajtjen e shënimeve (p.sh. prodhuesit regjistrojnë të gjitha substancat e aplikuar në të mbjella, sasi të sakta, datat e aplikimit), përdorimi i varieteteve të farave të certifikuar dhe plehrave, ujtitja pa ujë të kontaminuar dhe Menaxhimi i Integruar i Dëmtuesve.

3. Pse Local GAP është një mundësi e mirë për supermarketet?

Prania e produkteve me standard localg.a.p është një vlerë e shtuar për supermarketet. Fillimisht, supermakete që përdorin këto standarde, mund t’ju sigurojnë konsumatorëve produktet lokale të prodhuara sipas praktikave të mira bujqësore. Ato konsiderohen si një alternativë për konsumatorët që dëshirojnë të shmangin rreziqet shëndetësore nga ndotja kimike e produkteve. Përveç përfitimeve për shëndetin dhe sigurinë e njeriut, produktet localgap janë gjithashtu praktika miqësore me aspektet mjedisore, si edhe mund të rrisin mirëqenien e kafshëve dhe mund të promovojnë biodiversitetin. Duhet theksuar që këto produkte mund të jenë të qëndrueshme nga pikëpamja ekonomike duke qënë se prodhohen afër zonave të lokalizuara këto ferma si dhe reduktuar kostot e transportit.

Rihapen programet e doktoraturës në UBT

Ministri Federal i Gjermanisë për Bujqësinë dhe Ushqimin, Cem Özdemir, gjatë vizitës zyrtare që zhvilloi në Tiranë, me ministren e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, u takua edhe prof. dr. Fatbardh Sallaku, rektor i Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Ministrja Krifca publikoi në rrjetet sociale foto nga ky takim, teksa vuri në dukje, se “diskutuan mbi një ndër punët e mira të këtij viti që kemi bërë bashkërisht për UBT-në, për rihapjen e programeve të doktoraturës mbështetur finan-

ciarisht edhe përmes qeverisë gjermane”.

“Një program që jam e sigurt që do i japë një frymë tjetër zhvillimi kërkimit shkencor dhe kualifikimit të këtyre doktorantëve në fushat e nevojshme për bujqësinë dhe zhvillimin rural, duke ofruar për herë të parë programe të përbashkëta me universitetet e mirënjohura në Europë, si Universiteti Giessen (Gjermani), Instituti IAMO (Gjermani), Universiteti Karlsruhe (Gjermani), University of Hohenheim (Gjermani), Universiteti BOKU (Austri),

etj”, theksoi Krifca.

Ministrja tha se ky bashkëpunim synon përfshirjen e sa më shumë të rinjve në sektorin bujqësor dhe rural, kualifikimin e mëtijshëm të studentëve ekselentë dhe profesionistëve të rinj.

“Gjithashtu, deklaroi ministrja, synojmë forcimin e bashkëpunimit ndërmjet universitetit, sektorit publik dhe privat në Shqipëri si dhe integrimin e njohurive teorike me ato praktike, duke përfshirë shembujt më të mirë të Bashkimit Evropian”.

Krifca: 14% rritje të buxhetit për përballimin e ndryshimeve klimaterike

(Vijon nga faqja 6)

çdo vit adresojmë një buxhet i posaçëm për këtë qëllim.

“Këtë vit ne kemi rritur me 14% buxhetin për përballimin e ndryshimeve klimaterike, për sa i takon infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit mbrojtjes së përmbytjet që përbën një nga zërat kryesorë në inves-

timet publike që duhen ndërmarrë për të përballuar këto efekte.

Investimet në sektorin e bujqësisë janë të orientuar drejt ekonomisë së gjelbër, në funksion të efekteve klimaterike dhe ne po përpiqemi të orientojmë investimet sipas modeleve që ndjek dhe BE në këtë drejtim”, u shpreh ministrja.

Krifca deklaroi se “ne kemi një bujqësi të bazuar në praktika ku nuk përdoren shumë pesticide dhe po punojmë me një projekt francez për uljen e CO2 në fermën blegtorale, ndërsa shembujt pozitivë po na shërbejnë për të krijuar modele në sistemet prodhuese në bujqësi dhe blegtori”.

CIHEAM

Ministrja e Bujqësisë së Shqipërisë Frida Krifca zgjidhet Presidente e Bordit Drejtues të Qendrës Ndërkombëtare për Studime të Avancuara Agronomike Mesdhetare

(Vijon nga faqja 5)



PUBBLICAZIONI

PRODUZIONE INTEGRATA

INTERREG II ITALIA-ALBANIA
9
DIFESA DELL'OLIVO
MBOJTJA E ULLIRIT

BIODIVERSITA

OPTIONS méditerranéennes
"Italo-Albanian cooperation for enhancement of the plant biodiversity"

AGRICOLTURA BIOLOGICA

Albania

SUOLO

20 Monografie
81 pubblicazioni in riviste scientifiche



**MBËSHTETJE FINANCIARE
PËR TË GJITHË FERMERËT**

**KREDI E DEDIKUAR
PËR MBJELLJEN E GRURIT**



PROFIL

Ëndrra amerikane u bë realitet

- Kushtuar familjes së agronomit Selman Skëndajt, që prej 23 vjetësh jeton në Amerikë -

Fuat Memelli, Boston

Ndër shqiptarët e shumtë që kam takuar në Boston, është edhe agronomi Selman Skëndaj. Biseda me të më la mbresa të veçanta. Më la sepse ai më foli se si përmes sakrificash e punë të ndershme, familja e tij e bëri realitet ëndrrën amerikane. Ky shëmbull është vërtet një model, ndaj mendova t'ia dërgoj gazetës "Agrobiznes", e vetmja gazetë në Shqipëri që mban "erë" bujqësi.

Nga vinte Selmani?

Para se të ndalem te "shkallët

anglisht dhe djali i parë u bë përkëthyes i familjes sidomos për nevojat e rëndësishme. Selmani dhe Suzana punonin nga 10-12 orë në ditë gjatë gjithë javës, ajo turni i parë dhe ai i dytë për të mos i lënë fëmijët vetëm. Ndër problemet e para

punoi në kompani të ndryshme për të mësuar se çfarë shërbimesh ofronin ata. Punoi 10-12 orë në ditë. E filloi biznesin pa marrë kredi dhe duke mos patur asnjë klient. Shkoi derë më derë për të gjetur klientë. Sot ai ka dy kategori klientësh: 65 për qind janë kompani tregtare dhe 35 për qind shtëpi private. Kompanive u shërben një herë në muaj për të mbrojtur

sot punojnë juristë në kompani të njohura. Familja bleu edhe një shtëpi të bukur me vlerë një milion dollarë. Me këto aritje familja Selmani e quan të realizuar ëndrrën amerikane.

Kopshti i tij, një mozaik i qëndësuar bukur

Disa vjet më parë kam shkruar për kopshtet e shqiptarëve

një kopsht i tillë në pak kohë, por ja që kjo është e vërtetë. Krahas biznesit atij i "hanin" duart për punë të tjera që kishin lidhje me bujqësinë. E nxiste këtë dëshirë profesioni i tij i agronomit që kishte punuar në Shqipëri rreth 20 vjet. Siç ka thënë një mendimtar "një pasion i vërtetë që digjet brenda shpirtit tënd, është ai që nuk mund të shuhet." Dhe pasioni i Selmanit nuk ishte shuar. I hyri punës për ta kthyer tokën djerrë në një kopsht të bukur. E punoi tokën me krahë në thellësi 1,25

qepë, presh, hudhra, spinaq, brokol, spinaq, kunguj, etj si dhe erëza. Ka mbjellë trëndafila e lule të ndryshme si dhe pesë varietete hardhish. Po t'i numërosh bëhen rreth 30 lloje bimësh e fidanë frutorë. Duke i qëndruar te "koka" me shërbime të ndryshme si plehra organike, prashitje, ujitje, bimët rriten ashtu si do ai. Kopshti i tij është organik, pasi ai nuk përdor fare kimikate. Çdo mbasadite vonë, pasi kthehet nga puna që ka në biznesin e tij, shkon te kopshti ku punon rreth dy orë çdo ditë. "Punën në kopsht e kam si çlodhje. E bëj për qejf këtë punë, jo për biznes. Siguroj perimet që më duhen për familjen. Një pjesë ua jap të tjerëve. Kur shkoj te bimët dhe merem me to, më duket sikur i përkëdhel", thotë



e ngjitjes "së Selmanit dhe familjes së tij në Amerikë, po them pak fjalë se nga vinte ai. Origjinën e ka nga fshati Peshtan 2 i Beratit. Është diplomuar për agronomi në ish-Institutin e Lartë Bujqësor. Për rreth 20 vjet ka punuar agronom në disa ekonomi si dhe kryeagronom i rrethit të Kuçovës. Kur e nxorrën nga puna pas viteve '90, nuk trokiti në zyrat e shtetit, por filloi biznesin e tij në fushën e shërbimit këshillimor për fermerët. Një shkrim i botuar te revista "Bujqësia" të cilën e ka marrë me vete, tregon se ai ishte i pari që hapi biznesin e tij në këtë fushë.

Shkallët e ngjitjes të kësaj familje në Amerikë

Familja e Selmanit erdhi në Amerikë me llotari 23 vjet më parë dhe u sistemua në qytetin e Bostonit. As ai, as gruaja, as dy djemtë e vegjël nuk dinin anglisht. Selmani dhe gruaja e tij Suzana në Shqipëri kishin bërë rusisht por nuk e ushtruan. Djali i parë, Arbri 8 vjet shkoi në shkollë ndërsa Elti 4 vjet në kopsht. Pas një viti ata mësuan

ishte mësimi i gjuhës angleze, pasi pa e ditur atë je memec në Amerikë. Burrë e grua filluan kursin një vjeçar në Universitetin "Clark". Për mundësitë e tyre kurse që i shtrenjtë por e përballuan. Suzana filloi punë si menaxhere në një kompani kafeje, ndërsa Selmani vazhdoi të mësojë edhe tre muaj si autodidakt. Ai mori licencë për të punuar në një kompani të kontrollit të pesticideve me një rrogë dyfish më të madhe se ajo që merte më parë. Më pas të dy bënë ekuivalimin e diplomave që kishin marrë në Shqipëri, ajo si financiere ndërsa ai si agronom i përgjithshëm. Të dy morën "Master degree". Suzana filloi punë si financiere në Universitetin "Clark", ndërsa Selmani mori "Master Degree" për entomologji. Më pas ai vazhdoi kursin dy vjeçar për të marrë licencën "Pest management service". (Shërbim i menaxhimit të dëmtoesve) në 6 shtete të New England (Anglia e re). Në gusht të vitit 2010, regjistroi biznesin e tij në shtetin e Massachusetts me emrin "Pro green pest management". Ai



bizneset e tyre nga insektet që dëmtojnë ushqimet, hotelet për çimkat e tartabiqët, ndërsa në shtëpitë private për t'i mbrojtur nga dëmtoesit e trupit. Ai përdor preparate organike që nuk dëmtojnë njerëzit, kafshët dhe mjedisin. Ky lloj shërbimi është e ardhmja në Amerikë. Me të ardhurat e tyre Selmani dhe Suzana ndihmuan djemtë, Arbrin dhe Eltin, të cilët mbaruan nga dy universitete dhe

në Boston dhe qytetet e tjerë rreth tij, të mbjella me bimë e pemë të ndryshme. Por, sivjet pasi pashë nga afër kopshtin e agronomit Selman Skëndaj, them se ai është më i bukuri ndër kopshtet e shqiptarëve që kam parë deri tani në Amerikë. Është me të vërtetë një mozaik i bukur. Sipërfaqja e kopshtit është 300 metra katrore dhe shtrihet rreth shtëpisë. Është e pabesueshme si mund të bëhet



m. Tokën e siti dhe veçoi gurët e mëdhenj si dhe ata të vegjël sa një bërthamë qershije. Me këtë punë u muar tre muaj, pasi kthehej nga puna e parë. Më pas mori tre mostra toke dhe i çoi në tre laboratorë privatë, për të parë në ç'gjëndje ishte përmbajtja e elementëve kryesorë, azot, fosfor, potas si dhe aciditeti. Toka doli me strukturë të mirë dhe vlera mesatare. Mbështetur në kërkesat e bimëve që do mbillte, bëri skemën e mbjelljeve dhe gjeti nënshartesa që nuk rriten shumë. Mbolli mollë, dardha, pjeshka, qershi, kumbulla, ftua, thanë si dhe fiq në vazo. Te një rrënjë mollë shartoi katër varietete. Sythat i ka marrë te kopshtet e miqve të tij amerikanë, duke vëzhguar më parë prodhimin tyre që të zgjidhte atë që i pëlqente. Mbjell perime si domate, tranguj, specia,

Selmani. Më shumë se fjalët e mia, për këtë kopsht të bukur, flasin fotografitë që shoqërojnë këtë shkrim.

Për të qenë në korent me të rejtat e kopshtarisë, ai studjon vazhdimisht literaturë amerikane. Ka një bibliotekë të pasur me encikloedi të viteve të fundit. Këtë e arriti pasi vazhdoi shkollën për gjuhën angleze, të cilën tashmë e zotëron mirë. Selmani po i afrohet 70 viteve por vazhdon të punojë si një djalë i ri. Pasioni për punën, e bën që të mos njohë vitet që ka mbi shpinë. Veç punës me biznesin e tij, me kopshtin e punë të tjera familjare, prej vitesh shkruan mbresa e opinione me të cilat ka mbushur disa fletore. Ato kërkon t'i botojë më vonë. Siç ka thënë Gëte "jetova aq sa punova" dhe Selmani duket se e ka moto të jetës së tij këtë thënie të shkrimtarit të shquar.

Zëvendësministri Civici: Synojmë politika që lehtësojnë sipërmarrjet rurale, eksportet bujqësore janë rritur në vlerë dhe sasi

(Vijon nga faqja 2)

shpreh ai.

Kryetarja e Unionit të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Ines Muçostepa theksoi qëndrueshmërinë e këtij organizimi ndër vite si një event shumë i rëndësishëm për bashkëpunimin e biznesëve në sektor.

"Dua të vlerësoj një panair për këtë sektor kaq të rëndësishëm ku kanë marrë pjesë kaq shumë kompani dhe jo vetëm nga vendi ynë por edhe nga jashtë. Sektori ka njohur kaq shumë kriza por në vitin 2023 ka shumë gjasa që të shohë një rritje dhe kontribut pozitiv në ekonominë e vendit".

Ajo shtoi se në këtë sektor problematikë ka qenë marrëdhënie në tregti si dhe prezantimi i produkteve Made in Albania dhe ky panair është një ndihmë e madhe në këto nis-mat-ha Muçostepa.

Disa nga partnerët kryesorë të panairit u shprehën se bashkëpunimet midis bizneseve janë esenciale për këtë sektor, prandaj një fokus kryesor për ta është edhe bashkëpunimi me kompanitë e huaja.

Një tjetër faktor kryesor për zhvillimin e këtij sektori është edhe incovacioni në teknologji dhe përdorimi i makinerive që sjellin një efikasitet në prodhim.

Në sektorin e bujqësisë janë ngritur dhe po zhvillohen shumë biznese, falë skemave të mbështetjes dhe programit IPARD.

Drejtoresha e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Eranda Sinanaj vizitoi së bashku me atasheun austriak në Beograd Christian Brawenz, dy nga sipërmarrjet e suksesshme të mbështetura nga programi IPARD II.

"Tris Alb" dhe "Vjen" shpik janë dy nga feramat më të mëdha të cilat ndodhen përkatësisht në Libofshë të Fierit dhe në Grabian të Lushnjës.

Ato janë sipërmarrje të suk-

sesshme të cilët merren me mbarëshkrimin e bagëtive dhe

prodhimin e qumështit.

Në sajë të programit IPARD

IPARD mbështet zgjerimin e kapaciteteve prodhuese në fermat blegtorale



II është mundësuar zgjerimi i kapaciteteve përmes blerjes së makinerive dhe pajisjeve të teknologjisë së lartë si dhe shtimi i hapësirave të fermës. Pajisja me mjetet e duhura për mjeljen dhe ruajtjen e qumështit, ka mundësuar cilësinë e kërkuar dhe rritjen e sasive të litrave të grumbulluara çdo ditë.

Gjatë kësaj vizite, ata u ndalën edhe në Shkollën e Mesme Bujqësore në Fier ku u njohën me ambientet e reja, teknikat mësimore si edhe projektet e planifikuara me qëllim formimin e duhur të profesionistëve të së ardhmes në fushën e bujqësisë, blegtorisë, etj.

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE LUSHNJE

Fara e grurit është elementi më i rëndësishëm i procesit të prodhimit bujqësor në këtë kulturë. Ajo përmban në vetvete bimën e re, nga e cila varet prodhimi që do të merret. Të gjitha shërbimet kulturore, përgatitja e tokës, plehërimi dhe ujëtja, lufta ndaj sëmundjeve, dëmtusve e barërave të keqja, nuk mund të japin frytshmerinë e duhur, nëse fara e grurit është me tregues të cilësisë së dobët.

Për arsye të cilat i cilësuam me lartë fermerët si fillim duhet të bëjnë përzgjedhjen e farës, duke përcaktuar mirë dhe me kujdes kultivarin që do të mbjellin. Është mirë që në këto raste ata të këshillohen me agronomët për zonat e tyre, (kjo gjë ka të bëjë me atë e cila quhet struktura e mbjelljeve), ose të kontaktojnë me specialist të qendrave ku tregtohet fara e grurit.

Mbjellja e grurit përfshin një sërë kërkesash ndaj përgatitjes së farës, normës së farës, kohës së mbjelljes, thellësisë mbjelljes, mënyrës së mbjelljes e të tjera probleme. Të gjitha këto procese kërkohet të realizohen me cilësi shumë të lartë dhe në harmoni me kushtet konkrete të tokës, klimës dhe kultivarit.

PËRGATITJA E FARËS PËR MBJELLJE

Për të realizuar një mbjellje me cilësi të lartë dhe në kohën e planifikuar çdo fermer duhet që të ketë marrë më parë disa masa të cilat po i citojmë si më poshtë:

- Fara e grurit përgatitet në kohën e duhur;

- Ajo pastrohet nga lënda e huaj;

- Trirohohet;

- Standardizohet;


- Kontrollonhet për cilësitë që ka;

- Dezinfektohet dhe ambalazhohet.

Fara e grurit që të lejohet për t'u mbjellë, duhet të jetë e kontrolluar për hallkën e riprodhimit, kategorinë dhe klasën e saj, në bazë të standarteve shtetërore. Fara mund të mbillet vetëm po qe se është super elite, elite, riprodhim i parë, ose i dytë, dhe e pastër nga sëmundjet. Fara e riprodhimit të tretë nuk lejohet për mbjellje.

KËSHILLA PËR FERMERË TË CILËT MERRN ME KULTIVIMIN E BIMËS SË GRURIT

Fermerët duhet që ta marrin farën të standardizuar dhe të certifikuar, ku në çdo ambalazh të jetë e stampuar certifikata e farës ku të jenë të shënuar treguesit e kësaj fare, si emri i kultivarit, fuqia mbirëse e cila duhet të jetë jo me pak se 95%, pastërtia analitike dhe pastërtia gjenetike përkatësisht të jetë jo me pak se



98% dhe 99%. Para mbjelljes për të parandaluar preken nga sëmundjet me origjinë nga fara bëhet dezinfektimi i saj me fungicide si falizan, dividend karefit tej, trajtimi bëhet 2-3 ditë para me 200-250 gr/kv farë.

AFATI I MBJELLJES

Afati i mbjelljes së grurit lidhet ngushtë me kushtet klimatike të zonës dhe karakteristikat biologjike të tij. Koha më e përshtatshme për mbjellje konsiderohet periudha më e mirë që jep garanci për një mbirje të mirë të bimës. Në këtë mënyrë me pak fjalë, mbjellja e grurit duhet të bëhet as shumë herët, as shumë vonë. Në rastin e mbjelljeve të hershme bima e grurit, mud të ketë premisë që të rrezohet, bima zhvillohet shpejt dhe kalon fazat e saj delikate kur temperaturat janë të ulëta. Në mbjelljet e vona mbirja dhe dalja e bimës mbi

sipërfaqe vonohet, nga temperaturat e ulëta. Në këtë rast bimët e reja janë të predispozuar të preken nga sëmundjet kërpudhore, zogjtë dhe të ftohtit. Si pasojë e mbjelljeve të vona nuk arrihet që të sigurohet një nga kriteret me kryesore të kësaj bime, që është numri i bimëve për metër katror, për ha, gjë e cila

ndikon negativisht në rendimetin e pritshëm që kemi planifikuar të marrim. Të dhënat studimore tregojnë se ndikimi i afatit të mbjelljes mbi rendimentin e realizuar është shumë i dukshëm. Si përfundim të kësaj çështje bëjmë me dije të gjithë fermerët se afatet më të mira për mbjelljen e grurit varen nga zona ekologjike e kultivimit, më konkretisht për zonën e ulët bregdetare afati më i mirë për mbjellje është nga data 10 deri në datën 25 nëntor.

THELLËSIA E MBJELLJES

Edhe thellësia e hedhjes së farës ndikon shumë në sigurimin e mbirjeve të shpejta, të shëndosha e të njëtrajtshme, si dhe në pjekjen e njëkohshme e sigurimin e rendimenteve të larta. Thellësia optimale e mbjelljes së farës së grurit konsiderohet 4-5 cm. Mbjellja më e cekët se 3cm shkakton mbirje jo uniforme, ndërsa

mbjellja në thellësi me të madhe veshitron mbirjen e bimëve të reja dhe daljen e tyre në sipërfaqe të tokës. Thellësia e mbjelljes së farës lidhet ngushtë me lagështinë në tokë në kohën e mbjelljes. Kur mungon vlaga, fara duhet të vendosen me thellë, në shtresën që ka lagështi të mjaftueshme për mbirje, kurse kur ka lagështi të madhe, mbjellja bëhet me cekët. Thellësia e mbjelljes varet edhe nga përbërja mekanike e tokës. Në toka të rënda deltinore mbjellja bëhet me e cekët, se sa në toka të lehta ranore.

NORMA E FARËS

Është një kriter shumë teknik dhe i rëndësishëm. Studime të shumta për numrin e bimëve në grurë kanë arritur në përfundim se: Faktoret kryesore që mba-hen parasysht në përcaktimin e normës së farës janë:

• Numri i bimëve të planifikuara për njësi të sipërfaqes.

Pesha e 1000 kokrrave;

Aftësia mbirëse;

Pastërtia analitike;

Përgatitja e tokës;

• Afati i mbjelljes. Për llogaritjen e normës së farës ka tre probleme që duhet të zgjidhen nga fermerët me shumë kujdes dhe të kërkohen dhe ndihmën e specialisteve, ato janë:

• Planifikimi i numrit të dëshiruar të bimëve për m² (ose ha)

• Korigjimi i normës së farës për efekt të kushteve të mbjelljes

• Përgatitja e mirë e shtratit ku do hidhet fara.

Faktor tjetër në përcaktimin e normës së farës është dhe pjelloria e tokës.

Lidhur me problemin e përcaktimit të normës së farës nuk mund të jepen receta të gatshme, por në përcaktimin e saj duhet të merren në konsideratë të gjithë faktorët e rritjes dhe cilësia e materialit mbjellës. Përsa i përket mënyrës së mbjelljes, gruri në vendin tonë mbillet vetëm me rreshta, të cilat realizohen nga makina mbjellëse të tipeve të ndryshme.

Sektori i Grurit: QTTB-Lushnje
E-mail: qttblushnje@yahoo.com

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE KORÇË

Për fermat e dhenëve dhe dhive

Ky material i këshillave për fermerët është për masat që duhet të merren për dimërimin e kafshëve.

Problemet për fermat dhe tufat e fermerëve për periudhën që fillon dhe vazhdon për disa muaj (2 muaj për zonën e ngrohtë dhe rreth 5 muaj për zonën e ftohtë), janë shumë deçizive në drejtim të prodhimeve blegtorale për vitin pasardhës.

Prandaj specialistët rekomandojnë që të zbatoni këto masa si më poshtë:

• Rishikoni edhe një herë strehimin e tufave si dhe paisjet që duhet të kenë ato.

• Siguroni strehim të ngrohtë dhe të thatë (evitoni lagështinë, korentet e ajrit etj) si dhe këto parametra për strehim dhe vëndngrenie:

KËSHILLA PËR FERMERËT QË MBARËSHTOJNË BAGËTI TË IMTA

- Lagështia e ajrit: jo më tepër se 70-80 % (mbulesa e trupit të kafshëve duhet të jetë e thatë).

TË LESHTAT:

Sipërfaqja e ndenjes me shtresë: m² krerë

• Qengja nën 2 muaj 0.25 m² / krerë

• Qengja mbi 2 muaj 0.50 m² / krerë

• Dele 0.70 m² / krerë

• Dele barsa 1.2 m² / krerë

• Dele me qengja 1.5 m² / krerë

Gjatësia e frontit të ngrënies (koritave) cm/krerë

• Qengja nën 3 javë 25 cm/krerë

• Të rriturat 33-40 cm/krerë

Temperatura optimale në °C të vend

strehimeve

• Qengjat e sapolindur 20-25 °C

• Qengja më të vegjël se 1 muajsh 18 °C

• Të rriturat (kafshë adulte) 13 – 15 °C

TË DHIRTAT

Sipërfaqja e ndenjes me shtresë m² krerë

• Për kecat nën 1 muaj 0.25 - 0.33 m² krerë

• Kecat në këputje 0.50-0.66

• Të rriturat 1.5 m² krerë duke siguruar 1 kg/kashtë /krerë në ditë

Gjatësia e frontit të ngrënies (koritave) cm/krerë

• Keca 20-25 cm/krerë

• Dhitë e rritura 33 cm/krerë

Temperatura optimale C të vend strehimeve

• Kecat e sapolindur 22 °C

• Keca më të vegjël se 1 muajsh 18 °C

• Dhi të rritura (adulte) 10 – 16 °C

Verifikoni vazhdimisht inventarin e bazës ushqimore përgjatë aktdimërimin të kafshëve.

Drejtorja e Teknologjive Blegtorale: QTTB- Korçë:
E-mail: qttbkorce@yahoo.com

Për sqarime të tjera kontaktoni:

Sotiraq Jankulla tel: 0682630700

E-mail: sotiraqjankulla@yahoo.com

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE KORÇË

Në vjeshtë, pas përfundimit të vjeljes së frutave, fillon përgatitja për vegetacionin e ardhshëm dhe me qëllim të zvogëlimit të infeksionit gjatë vegetacionit të ardhshëm bëhen trajtime (spërkatje), me preparate kimike për mbrojtjen e pemëve. Spërkatja vjeshtore realizohet para dhe gjatë rënies së gjetheve, pasi është një masë agroteknike obligative në pemishte, me të cilën eliminohen numër i madh i shkaktarëve të sëmundjeve dhe dëmtuesve të pemëve frutore.

Pas vjeljes në pemtore duhet të kryhen këto shërbime: largimin dhe djegien e mbeturinave gjetheve, së bashku me degët e thyera e të infektuara, grumbullimin dhe djegien e frutave të mumifikuara, me qëllim zvogëlimin e potencialit infektues në vitin e ardhshëm. Me spërkatje vjeshtore ndërhyhet në mënyrë preventive në eliminimin e zvogëlimin e infeksioneve nga shkaktarë të ndryshëm të sëmundjeve.

Shkaktarët e këtyre sëmundjeve dimërojnë në kurorat e pemëve, në fruta të kalbura në gjethe etj. Për të mos patur infeksione në vjeshtën e vonë dhe gjatë dimrave të butë, patogjenet, shkaktarë të sëmundjeve, eliminohen me spërkatje në vendimërimin e tyre.

Koha ideale për spërkatje të kaltër (vjeshtore) është muaji nëntor, mbas fillimit të rënies masive të gjetheve. Në spërkatje vjeshtore përdoren preparate me bazë bakri, gjithashtu arrihet dezinfektim i kurorës së pemëve nga dëmtues të ndryshëm si morri i gjetheve, merimaga dhe dëmtues të tjerë. Preparatet për spërkatje vjeshtore (kaltër), i takojnë

Drejtorja e Teknologjive Bujqësore: QTTB-Korçë:
E-mail: qttbkorce@yahoo.com

KËSHILLA PËR KULTIVUESIT E MOLLËS, NËNTOR 2022

grupit me bazë bakri, prej të cilave mund të rekomandojmë:

- Tretësirë Bordoleze me koncentrim (2%)
- Blauvit (1%)
- Oksiklorur bakri 50 (0.75%)
- Kupragin (0.35%) etj.

Plehërimi i pemëve frutore

Bimët rriten dhe zhvillohet mjaft mirë vetëm atëherë, kur ato plehërohen në dozat e elementëve Azot, Fosfor, Potas, si dhe me një sërë mikroelementësh të tjerë. Elementët ushqimorë ndahen në dy grupe kryesore. Ato janë: i) Makroelementet, (ku bëjnë pjesë N₂O, P₂O₅ dhe K₂O); ii) Mikroelementet, ku më kryesorët janë: Magneziumi, Mangani, Calciumi, Bori, Bakri, Hekuri, Zinku, Natriumi, Squfuri, etj.

Disa nga këto elementë gjenden me shumicë në tokë dhe nuk ndihet nevoja e plehërimit. Ndërsa disa nga këto kryesisht N, P dhe K, nuk gjenden në proporcionet e duhura dhe për këtë arsye lind nevoja e plehërimit. Plehërimi i pemëve bëhet në këto afate:

a - Vjeshta; Konsiston në përdorimin e plehrave organike, potasike dhe ato fosforike. Koha më e përshtatshme është muaji Tetor. Në këtë periudhë pemët fillojnë të hyjnë në qetësinë dimërore dhe kërkesat për elementë ushqimorë pothuajse minimizohen. Atëherë lind pyetja, duke qenë se bimët në këtë periudhë hyjnë në qetësinë dimërore, përse duhet të hidhen këto plehra në këtë periudhë? Aresyeja e hedhjes së këtyre plehrave në këtë periudhë është se; i) Plehurat organike gjatë përmbysjes



në tokë gjatë Vjeshtës, deri në fillimin e zgjimit të pemëve në Pranverë, lënda organike dekompozohet plotësisht dhe elementët ushqimorë mineralizohen duke u bërë të gatshëm për t'u asimiluar nga pemët. Po kështu edhe për plehurat fosforike dhe ato potasike.

Rekomandohet që plehurat azotike për pemët që akoma nuk kanë hyr në prodhim, të

plehërohen në Vjeshtë me ¼ e sasisë së planifikuar.

Normat e plehërimit, varen nga mosha e pemëve, lloji i species, pozicioni dhe relievi

i tokës, gjendja dhe sasia e elementëve ushqimorë në tokë, etj. Kështu pjeska kërkon më shumë azot, ndërsa kumbulla kërkon më shumë potas. Pemët e reja zakonisht plehrohen në mënyrë të lokalizuar, vetëm në atë sipërfaqe toke ku ndodhet sistemi rrënjor. Gradualisht, me rritjen e pemëve rritet dhe sipërfaqja e plehëruar.

Tabelë 1. Sasia e plehrave që duhet të përdoren për një pemë (në toka të paujtëshme).

Moshja e pemës pas mbjelljes në pemtore (në vite)	Diametri i rrethit të tokës që duhet të plehrohet (m)	Pleh organik (kg)	Plehëra minerale (gr)		
			Nitrat amoni me 33% N ₂₆₀ O	Superfosfat me 18% P ₂ O ₅	Sulfat Potasi me 48% K ₂ O
1-2	2	15-20	60	100	180
3-4	2,5	25-30	75	130	240
5-6	3	30-40	130	230	420
7-8	3,5	45-50	170	300	560
9-10	4	55-60	230	430	750
11-12	4,5	80	300	600	1000

Tabelë 2. Sasia e plehrave që duhet të përdoren për një pemë (në toka të ujtëshme)

Moshja e pemës pas mbjelljes në pemtore (në vite)	Diametri i rrethit të tokës që duhet të plehrohet (m)	Pleh organik (kg)	Plehëra minerale (gr)		
			Nitrat amoni me 33% N ₂₆₀ O	Superfosfat me 18% P ₂ O ₅	Sulfat Potasi me 48% K ₂ O
1-2	2	10-15	80	140	60
3-4	2,5	15-20	110	200	75
5-6	3	25-30	180	340	130
7-8	3,5	35-40	250	460	180
9-10	4	45-50	330	600	240
11-12	4,5	60-70	350	700	300

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUIJË

TË USHQYERIT E DOSAVE GJATË FAZËS SË LAKTACIONIT

Të ushqyerit e dosave në nivele të mjaftueshme gjatë fazës së laktacionit nevojitet për të realizuar:

a) Maksimumin e prodhimit të qumështit (rezulati: maksimum i peshës së gicave në këputje)

b) Minimumin e humbjeve të rezervave ydn-dyore dhe proteinike (rezulati: shkurtime në intervalit këputje-fekondim/ndërzim, dhe rritje e madhësisë së çerdhes në pjelljen e ardhshme).

Rezervat trupore të cilat dosat i vendosin gjatë periudhës së mbarshmërisë i humbasin ato (kryesisht indin dhjamos) gjatë laktacionit. Midis fazës së mbarshmërisë dhe laktacionit ekzistojnë disa lidhje. Dosat me peshë më të madhe dhe rezerva të shumta dhjamos në momentin e pjelljes, kanë mundësi më të mëdha për të mobilizuar rezervat trupore gjatë laktacionit dhe të rriten në mënyrë më të shëndetshme gicat e tyre. Midis aftësisë ngrënëse (oreksi) pas pjelljes dhe sasisë së ushqimit të konsumuar gjatë mbarshmërisë ekziston një korrelacion negativ. Një rritje prej 0.5 kg ushqim në ditë gjatë mbarshmërisë, mund të rezultojë me një rënie të konsumit të ushqimit 0.5 kg/ditë gjatë laktacionit, por zakon-

isht korrelacioni është shumë i dobët.

